



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Analiza e opinionit publik dhe politikave

Ndikimet socio-ekonomike gjinore të COVID-19 tek gratë

Author: Petra Āurinová

qershor 2021

Ky Publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PMP), e mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PMP, zbatohet nga Instituti Nacional Demokratik (IND), Instituti për Demokraci „Societas Civilis“ – Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Kriza (QMK). Përmbajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i reflekton pikëpamjet e SDC.

Përmbajtja

HYRJE	5
Barra e kujdesit të papaguar	5
Sfidat financiare - shkurtimi i orarit të punës, humbja e vendeve të punës	6
Dhuna në bazë gjinore	8
Situata me gratë rome	8
Koha / hapësira që gratë të angazhohen në udhëheqje dhe procesin e vendimarrjes në politikë	9
Në përgjithësi	10
Qëllimet e hulumtimit	10
Hipotezat	11
Situata në Maqedoninë e Veriut	11
ANKETIMI I GRAVE DHE VAJZAVE NË MAQEDONINË E VERIUT	14
Rezultatet nga anketa	14
Shqetësimet në lidhje me situatën me Covid-19	15
Pasojat financiare	15
Shfrytëzimi i ndihmës / masës financiare	18
Kujdesi për fëmijët dhe më të moshuarit / personat me aftësi të kufizuara	19
Mbrojtja e shëndetësore	20
Sfidat	21
PRAKTIKAT MË TË MIRA NGA VENDET E TJERA - MASA SPECIFIKE PËR TË MBËSHTETUR GRATË DHE VAJZAT	24
Masat për kompensimin e të ardhurave	24
Shtesat prindërore dhe përfitimet për kujdes gjatë pandemisë / harmonizimi i jetës private dhe profesionale në kohë krize	25
Ndihma financiare SOS për ata që nuk mund të kërkojnë ndihmë tjetër / qasje deri te papunësia e pjeshme	27
Programi i shtesës për sëmundje / Ditë të lira për personat e sëmurë	27
Masat për të përfshirë dhe mbrojtur gratë punëtore në sektorin joformal	28
Masat për parandalimin e dhunës me bazë gjinore	28
Roli i parlamenteve	30
REKOMANDIME PËR NDRYSHIMIN E POLITIKAVE EKZISTUESE DHE PREZANTIMIN E POLITIKAVE TË REJA NË MAQEDONINË E VERIUT	31
Rekomandimet për miratimin e masave për kompensim të të ardhurave	31
Rekomandime për të lehtësuar barrën e grave që kujdesen për fëmijët, familjen, të moshuarit dhe shtëpinë	31
SOS Ndihma financiare universale për ata që nuk mund të kërkojnë ndihmë tjetër / qasje në ndihmë të pjeshme të papunësisë	32
Programi për kompensim gjatë sëmundjes / Ditë të lira për persona që janë të sëmurë	33
Rekomandim për të përfshirë dhe mbrojtur gratë emigrante që punojnë në sektorin joformal	33
Rekomandime për parandalimin e dhunës me bazë gjinore	33
PËRFUNDIM	35
BIBLIOGRAFIA	36
SHTOJCA 1: KËRKIM MBI NDIKIMIN E PANDEMISË COVID-19 TEK GRATË DHE VAJZAT	38

Impressum

Titull: Ndikimet socio-ekonomike gjinore të COVID-19 tek gratë

Botues: Instituti Demokratik Kombëtar

Authorë: Petra Āurinová

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

305-055.2:[616.98:578.834(497.7)](047.31)

305-055.2:316.334.2(497.7)(047.31)

ĀURINOVÁ, Petra

Ndikimet socio-ekonomike gjinore të Covid-19 tek gratë / authorë Petra Āurinová ; [përktim Florije Elezi]. - Shkup : Instituti demokratik kombëtar, 2021. - 120 стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Gendered socio-economic impacts of Covid-19 pandemic on women / author Petra Āurinová. - Фусноти кон текстот. - Bibliografia: стр. 37-38. - Содржи и: Aneks 1

ISBN 978-608-4921-08-0

а) Родови студии -- Социо-економски аспекти -- Ковид-19 -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 54336261

Hyrje

Për efektet shkatërruese të pandemisë së COVID-19 mbi gjendjen sociale dhe ekonomike të njerëzve në botë janë shkruar disa artikuj dhe punime profesionale. Megjithatë, popullata njerëzore nuk është grup homogjen. Prandaj, mund të pritet që efektet sociale dhe ekonomike të kësaj pandemie të kenë efekte të ndryshme mbi gratë në krahasim me burrat. Për më tepër, identitetet e ndryshme të ndërthurura të grave janë gjithashtu një faktor në ndikimet diferenciale që ato ndiejnë - përfshirë mundësinë e tyre për qasje në burime dhe në procesin e vendimmarrjes. Për shembull, gratë rreth historikisht janë marginalizuar dhe diskriminuar në shoqëri për shkak të ngjyrës së tyre të lëkurës dhe përkatësisë etnike. Për arsye të këtij marginalizimi historik, puna e tyre në ekonominë joformale dhe sektorët ruralë po përballen me një barrë shtesë dhe ndikim negativ si rezultat i COVID-19. Është e qartë se pandemia dhe problemet ekonomike që rezultojnë nga ajo kanë një efekt regresiv në barazinë gjinore, dhe kjo vlen edhe për gratë në kuadër të krijimit të politikëbërjes dhe në vendimmarrje. Studime

të ndryshme para pandemisë kanë treguar se gratë deputete duhet të përballen me sfida më të mëdha sesa homologët e tyre burra dhe se, që nga fillimi i pandemisë sfidat e tilla janë përkeqësuar edhe më shumë.¹

Gratë dhe vajzat përballen me forma të ndryshme të diskriminimit. "Edhe pse të gjithë janë të cenuar nga COVID-19, njerëzit definitivisht nuk goditen njësoj nga pandemia. Ekzistojnë dallime të dukshme gjinore, dhe personat më të marginalizuar janë më të goditurit. Gratë dhe vajzat po përballen me një rrezik në rritje të dhunës në familje, qasje joadekuate në kujdesin shëndetësor primarë (si para dhe ashtu edhe gjatë pandemisë), ndëshkim lidhur me COVID-19, pasiguri ekonomike dhe imponim të punës së papaguar dhe të papranuar gjatë dhënies së kujdesit. Kur kjo do të kombinohet me stigmën dhe diskriminimin ndërsektorial me të cilat përballen gratë dhe vajzat e marginalizuara, shihet qartë se gratë dhe vajzat padyshim janë të "harruara".²

Barra e kujdesit të papaguar

Nëse merret parasysh se në nivel botëror gratë zënë pjesën më të madhe të punës dhe kujdesit shtëpiak të papaguar³, mbyllja e shkollave për të kontrolluar transmetimin e COVID-19 në Evropë dhe më gjerë është treguar se kanë efekte të ndryshme dhe jo proporcionale mbi gratë. Sipas një studimi nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), "ekziston

një lidhje e drejtpërdrejtë midis shpërndarjes së pabarabartë të kujdesit të papaguar në familje dhe pabarazisë gjinore në tregun e punës. "Në BE, shumica e punës së papaguar të kujdesit bie mbi gratë, me 92% nga kujdesi i papaguar që ofrohet disa ditë në javë - përkundrajt 68% nga burrat."⁴ Gratë sigurojnë pjesën më të madhe të kujdesit joformal në

¹ SASKIA BRECHENMACHER, CAROLINE HUBBARD. 2020. How the Coronavirus Risks Exacerbating Women's Political Exclusion. Onlajn: <https://carnegieendowment.org/2020/11/17/how-coronavirus-risks-exacerbating-women-s-political-exclusion-pub-83213>

² UNAIDS.2020. *Six Concrete Measures To Support Women And Girls In All Their Diversity In The Context Of The COVID-19 Pandemic*. Onlajn: https://www.unaids.org/sites/default/files/media_asset/women-girls-covid19_en.pdf

³ TNH. 2018. *Unpaid Care and Domestic Work*. Online: <https://deeply.thenewhumanitarian.org/womensadvancement/background/unpaid-care-and-domestic-work>

⁴ European Institute for Gender Equality (EIGE).2020. *More equal sharing of care would reduce workplace gender inequality*. Onlajn: <https://eige.europa.eu/news/more-equal-sharing-care-would-reduce-workplace-gender-inequality>

familje, duke përfshirë por pa u kufizuar në kujdesin për anëtarët e familjes, shkollimin në shtëpi të fëmijëve të tyre, punën e papaguar në shtëpi. E gjithë kjo i kufizon ato për sa i përket punës dhe mundësive të tyre ekonomike. Në të njëjtën kohë, hulumtimi tregon se një në dhjetë gra të punësuar u detyruan të marrin pushim pa pagesë. Në rajon, pothuajse

10% e grave u dërguan në pushim pa pagesë, ndërsa gjashtë për qind morën pushim pjesërisht me pagesë. Si rezultat, gratë që punojnë në punë me pagë të ulët rrezikojnë më shumë të humbin punën e tyre dhe më pas të bien në varfëri nëse nuk merren masa për të subvencionuar të ardhurat e humbura.⁵

Sfidat financiare - shkurtimi i orarit të punës, humbja e vendeve të punës

Sipas Institutit Global McKinsey⁶, vendet e punës së grave janë për 1.8 herë më shumë të rrezikuara të humben gjatë krizës sesa vendet e punës për burra. Gratë përbëjnë 39 për qind të fuqisë punëtore globale, por me 54 për qind të të gjitha vendeve të humbura të punës. Një nga arsytet e këtyre pasojave kryesore për gratë është se virusi rrit ndjeshëm barrën e kujdesit të lartpërmendur të papaguar që bartet në mënyrë jo proporcionale mbi gratë. Kjo, ndër faktorë të tjerë, do të thotë që punësimi i grave po bie më shpejt se mesatarja, bile edhe kur merret parasysh fakti që gratë dhe burrat punojnë në sektorë të ndryshëm.⁷ Për më tepër, COVID-19 ndikon në mënyrë të konsiderueshme dhe jo proporcionale në ata sektorë ku kryesisht përfaqësohen nga gratë, dukuri e cila çon në humbje edhe më të mëdha të vendeve të punës për gratë. Bazuar gjithashtu në një vlerësim të shpejtë gjinor nga Zyra Rajonale e Grave pranë OKB-së (UN Women) për Evropën dhe Azinë Qendrore mbi 40 për qind e grave në Evropë dhe Azinë Qendrore gjatë periudhës së epidemisë punojnë në punë me

paga më të ulëta krahasuar me burrat (sondazhi i shpejtë i vlerësimit gjinor është kryer ndërmjet muajve prill dhe qershor 2020). Shkurtimi i orarit të punës me pagesë i grave vërehet në të gjitha nën-rajonet dhe vendet / territore. Gratë janë përgjithësisht më të goditura se burrat dhe përqindja e grave të cilave u është dashur të shkurtojnë orarin e punës është më e madhe. Duke pasur parasysh që pjesëmarrja e grave në tregun e punës ka qenë më e ulët se ajo e burrave para krizës, humbjet e vendeve të punës dhe oraret e reduktuara të paguara në mënyrë plotësuese do të përkeqësojnë edhe më tej pabarazitë në rajon, por edhe më shumë në këto vende / territore. Të dhënat e shpërndara tregojnë gjithashtu se humbja e orëve të paguara të punës ka pasur pasoja më të mëdha për gratë e reja të moshës 18-34 vjeç. Në shumicën e vendeve / territoreve, gratë më të reja kanë më shumë gjasa të raportojnë orë të reduktuara të punës (por pa humbur punën e tyre) në krahasim me gratë e grupmoshave të tjera. Epidemia veçanërisht ndikon tek gratë e vetëpunësuarat pasi që 25 për qind kanë

⁵ UN Women.2020. *THE IMPACT OF COVID-19 ON WOMEN'S AND MEN'S LIVES AND LIVELIHOODS IN EUROPE AND CENTRAL ASIA: Preliminary Results from a Rapid Gender Assessment*. Onlajn: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/the-impact-of-covid19-on-womens-and-mens-lives-and-livelihoods>

⁶ McKinsey Global Institute. 2020. *COVID-19 and gender equality: Countering the regressive effects*. Onlajn: <https://www.mckinsey.com/featured-insights/future-of-work/COVID-19-and-gender-equality-countering-the-regressive-effects#>

⁷ McKinsey Global Institute. 2020. *COVID-19 and gender equality: Countering the regressive effects*. Onlajn: <https://www.mckinsey.com/featured-insights/future-of-work/COVID-19-and-gender-equality-countering-the-regressive-effects#>

humbur vendet e tyre të punës (krahasuar me 21 për qind të burrave të vetëpunësuar) ndërsa 49 për qind në mënyrë plotësuese i kanë ulur orët e punës (kundrejt 53 për qind për burrat).⁸

Gjithashtu gratë emigrante në të gjithë botën janë në ballë të trajtimit të pandemisë COVID-19. Ato punojnë në vende të rëndësishme pune, por shpesh me pagë të ulët dhe të cenuara, si për shembull punonjëset e kujdesit shëndetësor, infermieret, punonjëset e higjienës dhe në lavanderi, me çka janë të ekspozuara në rrezik të lartë nga korona virusi⁹. Gratë në ekonominë joformale, përfshirë edhe shumë punëtore emigrante, janë në rrezik më të lartë për të humbur burimin e tyre ekzistencial, për t'u shkëlur dhe cenuar të drejtat e tyre të punës dhe të infektohen me korona virus. Këto punë specifike gjinore në ekonominë joformale, veçanërisht puna shtëpiake dhe sektori i kujdesit, shpesh janë me kontrata të pasigurta dhe pa pushim të paguar ose mundësi për të punuar nga shtëpia. Gratë në ekonominë joformale, si dhe gratë emigrante, gjithashtu kanë më shumë gjasa të punësohen me kohë të caktuar ose me kohë të shkurtuar. "Vendet e tyre të punës në përgjithësi janë të përjashtuara nga programet dhe kontributet për sigurim social, që do të thotë se rrjetet e sigurimeve sociale për të kompensuar të ardhurat e humbura janë ose të kufizuara ose inekzistente, dhe gjithashtu kanë qasje të kufizuara ose nuk kanë aspak qasje në mbrojtjen shëndetësor

dhe atë të lehonisë. Për shumicën e 8.5 milionë grave emigrante që janë punëtore shtëpiake, fillimi i pandemisë nënkuptonte humbje të vendit të punës, me ç'rast shëndeti dhe siguria e tyre injorohet dhe madje edhe cenohet. Për punëtoret shtëpiake emigrantë të cilët janë të vendosura në shtëpitë ku ata punojnë, humbja e vendit të punës nënkupton gjithashtu humbjen e vendbanimit të tyre. Vendosja e kufizimeve të udhëtimit ka rritur sfidat financiare dhe pasigurinë, duke i lënë shumë njerëz të bllokuar në vende larg shtëpive të tyre."¹⁰ Kjo vlen edhe për shumicën dërrmuese të grave, punëtore shtëpiake nga jashtë, anembanë Evropës, veçanërisht ato që udhëtojnë nga Evropa Qendrore dhe Lindore në Evropën Perëndimore. Për më tepër, pandemia e COVID-19 ndikon ndjeshëm në migrimin qarkullues të punëtorëve të kujdesit që jetojnë atje ku punojnë, midis vendit të tyre dhe shtëpive të pleqve në vendet e tjera evropiane. "Shumë prej tyre nuk kanë qenë në gjendje të kthehen në vendet e tyre të punës ose të fillojnë punë të re për shkak të kufizimeve të udhëtimit ose angazhimeve të anuluar, për shembull kur kujdestarët që është dashur t'i zëvendësojnë e kanë vazhduar angazhimin e tyre. Megjithëse qeveritë kanë zbatuar një numër masash të ndryshme për të lehtësuar pasojat ekonomike të pandemisë mbi kompanitë dhe punonjësit, shumë prej këtyre kujdestarëve që jetojnë në shtëpitë e kujdesit ku ata punojnë nuk kanë pasur të drejtë për një mbështetje të tillë."¹¹

⁸ UN Women.2020. *THE IMPACT OF COVID-19 ON WOMEN'S AND MEN'S LIVES AND LIVELIHOODS IN EUROPE AND CENTRAL ASIA: Preliminary Results from a Rapid Gender Assessment*. Onlajn: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/the-impact-of-covid19-on-womens-and-mens-lives-and-livelihoods>

⁹ UN Women.2020. *Addressing the Impacts of the COVID-19 Pandemic on Women Migrant Workers*. Onlajn: <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/guidance-note-impacts-of-the-COVID-19-pandemic-on-women-migrant-workers-en.pdf>

¹⁰ Ibid.

¹¹ Leibfingler M.; Prieler V.; Schwiter K.; Steiner J.; Benazha A.; Lutz H. 2020. *Impact of COVID19 Policy Responses on LiveIn Care Workers in Austria Germany and Switzerland*. Onlajn: <https://journal.ilpnetwork.org/articles/10.31389/jltc.51/print/>

Dhuna në bazë gjinore

Implikimet gjinore të shkaktuara nga karantina, siç është rritja e dhunës në bazë gjinore, gjithashtu duhet të identifikohen. Studiuesit kanë gjetur një lidhje midis pandemisë së COVID-19 dhe dhunës në bazë gjinore, shpesh e ashtuquajtur "pandemi në hije".¹² "Karantina e vendosur për t'u marrë me COVID-19 u ka dhënë më shumë liri dhunuesve. Disa raporte mediatike tregojnë një numër në rritje të rasteve të dhunës në familje në vende të ndryshme,"¹³ Në Australi, për shembull, shkalla e dhunës në familje është rritur për 5 për qind, Kina ka një rritje të trefishtë të rasteve të dhunës në familje që nga

vendosja e karantinës, shtete të ndryshme në ShBA gjithashtu raportuan një rritje prej 21-35 për qind të dhunës në familje, madje edhe Mbretëria e Bashkuar po përballet me shqetësime për shkak të rritjes së dhunës në familje.¹⁴ Dhuna ndaj grave dhe familjeve u raportua gjerësisht nga publiku gjatë valës së parë të korona virusit në Sllovakia. Numri i përgjithshëm i thirrjeve në Linjën Kombëtare Telefonike për Gratë Viktima të Dhunës në Institutin për Kërkime të Punës dhe Familjes janë dyfishuar midis marsit dhe qershorit 2020, kur Sllovakia shpalli gjendje të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë.¹⁵

Situata me gratë rome

Situata sociale dhe situata rreth punësimit të grave rome, jeta e tyre e përditshme, përfshirë edhe situatën e tyre socio-ekonomike dhe përvojën me diskriminimin, ngacmimin dhe dhunën dallojnë nga pjesa dërmuese e popullsisë në Maqedoninë e Veriut dhe në vendet e tjera të Evropës. Është e nevojshme të merret parasysh fakti që gratë rome shpesh punojnë punë sezonale ose punë të përkohshme, ose ofrojnë punë në tregjet lokale dhe në ndërmarrjet e vogla. Si pasojë nga korona virusi, shumë prej tyre u përballën me mbylljen e vendeve të tyre të punës dhe uljen e të ardhurave. Gratë rome përballen me diskriminim gjithnjë e më të madh, përfshirë edhe dhunën e bazuar në gjini (DhBGj),

me çka rritet cenueshmëria e tyre gjatë gjendjes së krizës. Me mbylljen e shkollave dhe transferimin e menjëhershëm të arsimit on-lajn gjatë pandemisë, shumë fëmijë romë mbetën pa arsim për shkak të mungesës së qasjes në kompjuter dhe internet.¹⁶ "Pandemia gjithashtu ka thelluar ndarjen e roleve gjinore në familjet rome. Përgjegjësitë e kujdesit janë bërë gjithnjë e më shumë përgjegjësi e grave, dukuri e cila në përgjithësi ka rritur barrën që ka rënë kryesisht mbi kurrizin e grave."¹⁷ Në një sondazh të kryer nga Qendra Kombëtare e Romëve në partneritet me UN Women, gratë rome kanë deklaruar se "numri i orëve që ato kalojnë në pastrim është rritur (70%), si dhe koha që ato kalojnë në gatim (62%)."¹⁸

¹² UN WOMEN. 2020. *The Shadow Pandemic: Violence against women during COVID-19*. Onlajn: <https://www.unwomen.org/en/news/in-focus/in-focus-gender-equality-in-COVID-19-response/violence-against-women-during-COVID-19>

¹³ Shalini Mittal; Tushar Singh. 2020. *Gender-Based Violence during COVID-19 Pandemic: A Mini-Review*. Onlajn: <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/fgwh.2020.00004/full>

¹⁴ Ibid.

¹⁵ IVPR. 2020. *Násilie na ženách a v rodinách verejnosť nahlasovala viac v období pandémie koronavírusu (Dhuna ndaj grave dhe familjeve u raportua gjerësisht nga publiku gjatë pandemisë së koronavirusit)*. Onlajn: <https://ivpr.gov.sk/nasilie-na-zenach-a-v-rodinach-verejnost-nahlasovala-viac-v-obdobi-pandemie-koronavirusu-tlacova-sprava/?fbclid=IwAR3Ymgha89uPJ4SmbxCllax-ynPX118Uvc9CrbagCltExNFChwR6T-vtv3Y>

¹⁶ UNHCR. 2020. *Many Roma families are particularly vulnerable in the current crisis of COVID-19*. Onlajn: <https://www.unhcr.org/ua/en/21189-many-roma-families-are-particularly-vulnerable-in-the-current-crisis-of-COVID-19.html>

¹⁷ Roma National Center in partnership with UN Women. 2020. *Roma population is affected disproportionately by the COVID-19 pandemic*. Onlajn: <https://moldova.unwomen.org/en/noutati-si-evenimente/noutati/2020/09/roma-women>

¹⁸ Roma National Center in partnership with UN Women. 2020. *Roma population is affected disproportionately by the COVID-19 pandemic*. Onlajn: <https://moldova.unwomen.org/en/noutati-si-evenimente/noutati/2020/09/roma-women>

Koha / hapësira që gratë të angazhohen në udhëheqje dhe procesin e vendimmarrjes në politikë

Zëri politik i grave është shumë i rëndësishëm në punën për çështje që lidhen me barazinë gjinore dhe prandaj përfaqësimi politik është thelbësor. “Edhe para pandemisë, progresi drejt barazisë gjinore ishte i pabarabartë. Pasojat gjinore të krizës me COVID-19 e theksuan progresin e pabarabartë drejt barazisë gjinore. Bota ka arritur progres në disa aspekte të barazisë gjinore, të tilla si vdekshmëria e nënave, pjesa e grave në punë profesionale dhe teknike dhe përfaqësimi politik.”¹⁹ Megjithatë, pandemitë shpesh fshijnë një progres të tillë. Për këtë arsye gratë e përfshira në politikë duhet të trajtojnë gjithashtu sfidat e vetme si dhe mundësitë unike të pandemisë nga COVID-19, ndërsa qeveritë në të gjithë botën duhet të marrin masa për të mbrojtur përfshirjen politike të grave gjatë pandemisë por edhe më gjerë. Rezultatet nga hulumtimet e Institutit Nacional Demokratik dhe partnerët e tij në Burkina Faso, Meksikë, Poloni dhe Ugandë²⁰ sugjerojnë se që nga fillimi i pandemisë sfidat e tilla janë përkeqësuar edhe më shumë gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme. Hulumtimi ka identifikuar katër rreziqe që paraqiten në raport me pjesëmarrjen politike të grave dhe

përfshirjen politike në kontekstin e COVID-19 - pasiguria ekonomike në rritje dhe kthimi i roleve tradicionale gjinore, duke kufizuar mundësinë dhe kohën që gratë të marrin pjesë në politikë; mbështetje më të madhe në praktikat joformale që mund të kufizojnë qasjen e grave në burimet e partisë dhe financat për fushata zgjedhore; pabarazia për qasje në platformat on-lajn dhe dukshmëria e zvogëluar publike e grave gjatë pandemisë e bëjnë më pak të mundshme që çështjet gjinore dhe fuqizimi politik të jenë në qendër të debatit politik me qetësimin e gjendjes së jashtëzakonshme. Megjithatë, është e rëndësishme të mbahet mend se vetëm “përfshirja e grave në organet vendimmarrëse nuk është e mjaftueshme për të siguruar politika të ndjeshme gjinore: politikanët dhe politikanet duhet të informohen dhe të japin llogari para lëvizjeve për drejtësi gjinore dhe sociale. Rrjetet e shoqërisë civile do të jenë thelbësore në sigurimin e miratimit dhe zbatimit të politikave progresive që mund të ndihmojnë në zbutjen e pasojave ndërmjet brezave nga pandemia e COVID-19 mbi barazinë gjinore.”²¹

¹⁹ McKinsey Global Institute. 2020. *COVID-19 and gender equality: Countering the regressive effects*. Onlajn: <https://www.mckinsey.com/featured-insights/future-of-work/COVID-19-and-gender-equality-countering-the-regressive-effects#>

²⁰ SASKIA BRECHENMACHER, CAROLINE HUBBARD. 2020. *How the Coronavirus Risks Exacerbating Women's Political Exclusion*. Onlajn: <https://carnegieendowment.org/2020/11/17/how-coronavirus-risks-exacerbating-women-s-political-exclusion-pub-83213>

²¹ SASKIA BRECHENMACHER, CAROLINE HUBBARD. 2020. *How the Coronavirus Risks Exacerbating Women's Political Exclusion*. Onlajn: <https://carnegieendowment.org/2020/11/17/how-coronavirus-risks-exacerbating-women-s-political-exclusion-pub-83213>

Në përgjithësi

Bazuar në gjetjet e mëparshme, mund të thuhet se në krahasim me burrat, jeta ekonomike dhe produktive e grave preket në mënyrë jo proporcionale dhe ndryshe nga kriza me COVID-19. Andaj, përgjigjja nuk duhet të jetë e verbër në aspektin gjinor. Literatura profesionale, të dhënat dhe gjetjet e paraqitura deri më tani tregojnë se jeta ekonomike dhe produktive e grave është e goditur nga kriza në mënyrë jo proporcionale dhe ndryshe nga ajo e burrave, duke pasur parasysh se "gratë fitojnë më pak, kursejnë më pak, kanë më pak vende pune të sigurta dhe kanë më shumë gjasa të

punësohen në sektorin joformal (p.sh. punë shtëpiake). Kanë më pak qasje në mbrojtjen sociale dhe përbëjnë shumicën e familjeve me një prind. Gratë gjithashtu harxhojnë në mënyrë jo proporcionale më shumë kohë sesa burrat në punë të papaguar në dhënie e kujdesit. Prandaj, aftësia e tyre për të absorbuar goditjet ekonomike është më e dobët se ajo e burrave.²² Ekziston gjithashtu një rrezik në rritje të dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar gjinore gjatë pandemisë së COVID-19.²³ Këto gjetje i sugjerojnë qëllimet dhe hipotezat e këtij punimi.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të identifikojë masat strategjike dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë që lidhet në mënyrë direkte me pasojat ekonomike nga COVID-19 mbi gratë dhe vajzat në Evropë. Prandaj, dokumenti i hulumtimit do të tregojë praktikën më të mira nga disa vende evropiane në lidhje me masat socio-ekonomike që synojnë eliminimin e efekteve negative të COVID-19 mbi gratë, përfshirë edhe rolin e parlamenteve në monitorimin e politikave publike. Bazuar në shembuj të praktikës së mirë nga vendet e analizuar si - Estonia, Gjermania, Sllovakia, Suedia dhe Zvicra - dhe rezultatet e një sondazhi telefonik për matjen e efekteve të COVID-19 mbi

gratë, përfshirë edhe gratë romë, në Maqedoninë e Veriut ky punim do të propozojë aktivitetet e nevojshme për të mbrojtur punëtorët në sektorin joformal dhe në sektorët e tjerë të cilët janë më të goditur nga pandemia. Gjithashtu punimi do të japë rekomandime në lidhje me atë se si të përshtaten programet ekzistuese kombëtare të mbrojtjes sociale për të siguruar të ardhura për gratë dhe vajzat e prekura nga pandemia me COVID-19 dhe për të forcuar rolin e mbikëqyrjes së Parlamentit në zbatimin e masave gjithëpërfshirëse të Qeverisë në luftën kundër COVID-19 dhe prezantimin e politikave të reja në Maqedoninë e Veriut.

²² ELSI Report. 2020. *Gender aspects of COVID-19 and pandemic response*. Onlajn: <https://scienctaskforce.ch/wp-content/uploads/2020/10/Gender-aspects-of-COVID19-and-pandemic-response-14-May-20-EN.pdf>

²³ IFRC. 2020. *Prevention and response to Sexual and Gender-Based Violence in COVID-19*. Onlajn: https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/IFRC-SGBV-COVID-19-Technical-Guidance-Note-FINAL_14May.pdf

Hipotezat

Deri më tani, literatura shkencore sugjeron se në nivel global gratë dhe vajzat përballen me forma të shumta të diskriminimit dhe preken në mënyrë jo proporcionale nga efektet shoqërore, ekonomike dhe politike të COVID-19. Prandaj, hipotezat e këtij punimi kërkimor janë si vijon:

H1: Gratë në Maqedoninë e Veriut përballen me rrezikun që të pësojnë dëme më të mëdha ekonomike nga çrregullimet e shkaktuara nga pandemia me COVID-19 sesa burrat.

H2: Një pjesë e madhe e grave mbetën pa punë për shkak të punës shtëpiake të papaguar dhe dhënies së kujdesit gjatë pandemisë në Maqedoninë e Veriut.

Situata në Maqedoninë e Veriut

Për të konfirmuar hipotezat, së pari është e nevojshme të krahasohen statistikat e disponueshme nga disa burime, të cilat përfshijnë përqindjen e grave të përfshira në ekonominë joformale; përqindja e rasteve të raportuara të vendeve të humbura të punës të grave të vetëpunësuar; përqindja e grave përgjegjëse për drejtimin e familjes; përqindja e grave të punësuar në industri që janë më të goditura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga COVID-19 dhe të gjitha të dhënat e tjera përkatëse dhe të disponueshme. Si një konfirmim i dytë do të përdoret analiza e një sondazhi telefonik.

Të dhënat e mbledhura nga departamenti i grave pranë OKB-së (UN Women) në Maqedoninë e Veriut tregojnë se fusha në të cilën ekzistojnë pabarazitë vazhdueshme gjinore në vend, madje edhe para pandemisë, është ekonomia, dhe pabarazitë janë veçanërisht të theksuara për sa i përket fitimeve dhe qasjes në burimet financiare.²⁴ „Gratë mesatarisht kanë të ardhura neto më të ulëta dhe të ardhura më të ulëta në krahasim me burrat dhe kështu përballen me një rrezik më të lartë të varfërisë. Gratë kanë

pozita shumë më të ulëta në pjesën e punësimit formal krahasuar me burrat (48.4 për qind e grave kundrejt 70 për qind të burrave), ndërsa më shumë se gjysma e personave joaktivë në tregun e punës janë gra me (64.4 për qind). Gratë e punësuar zyrtarisht gjithashtu fitojnë më pak se burrat. Siç tregojnë të dhënat e fundit mbi hendekun e parregulluar të pagave gjinore, pagat mesatare të grave janë për 15% më të ulëta se pagat e burrave. Kjo është për shkak të përfaqësimit më të ulët të grave në pozicione drejtuese, diskriminimit të tyre në tregun e punës dhe përfaqësimit më të lartë në industri me vlerësim më të ulët të punës dhe pagave më të ulëta. Burrat përfaqësojnë shumicën midis punëdhënësve (78%) dhe të vetëpunësuarit (82%). Gratë përfaqësojnë shumicën e të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Ato janë gjithashtu shumicë në industrinë e tekstilit me 24%, ku shumica (87%) marrin paga më të ulëta se mesatarja.“²⁵

Analiza e tyre konfirmon gjithashtu se ekziston ende një tendencë e ngarkesës jo proporcionale mbi gratë

²⁴ Marija Bashevska - UN Women. 2020. *RAPID GENDER ASSESSMENT: THE IMPACT OF COVID-19 ON WOMEN AND MEN IN NORTH MACEDONIA*. Onlajn: https://www2.unwomen.org/-/media/field_percent20office_percent20eca/attachments/publications/2020/09/rga_the_percent20impact_percent20of_percent20COVID-19_nm_eng_final_2020_09_29-min.pdf?la=en&vs=2420

²⁵ Ibid.

kur bëhet fjalë për punë dhe kujdes të papaguar shtëpiak. Këto obligime kryhen vazhdimisht dhe kryesisht nga gratë, dhe ato kryesisht përfshijnë obligime të tilla si gatim, pastrim, larje, mirëmbajtje të shtëpisë, kujdes për fëmijët dhe kujdes për të rriturit dhe personat me aftësi të kufizuara. Vlerësimet e fundit në vend tregojnë se gratë në Maqedoninë e Veriut bëjnë 72.5 për qind të punëve të papaguara shtëpiake dhe kujdesit të fëmijëve, gjë që ndikon ndjeshëm në aftësinë dhe kohën e tyre për të bërë punë të paguar, ndërtim karriere ose pjesëmarrje më të madhe në jetën publike, vullnetarizëm ose pjesëmarrje në aktivitete të tjera me interes.²⁶

Siç ka treguar edhe kjo analizë, duhet theksuar se "me COVID-19, përveç sektorit shëndetësor dhe punës së mjekëve, infermierëve dhe profesionistëve të tjerë të shëndetit, edhe disa aktivitete të tjera janë shfaqur si thelbësore për funksionimin e përditshëm. Këtu bëjnë pjesë industrinë e lidhura me prodhimin dhe shitjen e produkteve ushqimore, farmacitë, dyqanet dhe supermarketet, shërbimet financiare dhe mirëmbajtja e higjienës. Përkundër rekomandimeve të përgjithshme për punëdhënësit për të organizuar punën nga shtëpia aty ku është e mundur, në këta sektorë nevoja për prani fizike nuk ka ndryshuar, dhe për këtë arsye rreziku i ekspozimit ndaj infeksionit është rritur, duke imponuar kushte edhe më të vështira të punës. Në këto vende punë në Maqedoninë e Veriut dominojnë gratë (30% e grave të punësuar kundrejt 16 për qind e burrave të punësuar). Gratë përbëjnë përqindjen më të madhe të punonjësve të kujdesit shëndetësor, duke zënë 74% të numrit total."²⁷

Siç u potencua më parë, politikanët duhet të përqendrohen në trajtimin e shumë formave të ndryshme të diskriminimit dhe përmirësimin e qasjes për të gjitha gratë dhe vajzat në të gjitha masat socio-ekonomike që synojnë eliminimin e efekteve negative të krizës me Covid-19.

Siç deklaroi Stevo Pendarovski, Presidenti i Maqedonisë së Veriut, "pandemia e COVID-19 e thellon pabarazinë gjinore dhe nënvizon rëndësinë e vizionit transformues të paraqitur në Deklaratën e Pekinit." Është thelbësore të demonstrohet vullneti politik dhe përpjekjet e prekshme për të fuqizuar gratë dhe vajzat. Ai tha se Maqedonia e Veriut qëndron në përkushtimin e vet për barazi gjinore dhe Deklaratën për heqjen e pengesave sistematike për barazinë gjinore.²⁸ Për atë qëllim është shumë e rëndësishme që politikanët dhe palët e tjera të interesuara që janë përgjegjës për propozimin e veprimeve, masave, planeve të veprimit dhe ligjeve që synojnë arritjen e politikave socio-ekonomike të barabarta gjinore të mos mbeten vetëm në fjalën e tyre, gjatë dhe pas krizës, por duhet të luajnë një rol vendimtar në përshpejtimin e progresit drejt barazisë gjinore. Kjo është përgjegjësia e përgjithshme e të gjithë zyrtarëve të zgjedhur.

Për t'iu përgjigjur pandemisë me COVID-19, është e rëndësishme të theksohet se gratë nuk janë plotësisht të përfshira në procesin e vendimmarrjes në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut. Para zgjedhjeve parlamentare në korrik 2020, Qeveria ka pasur vetëm 5 ministre nga gjithsej 26 poste ministrore, ndërsa pas zgjedhjeve ka 4 ministre nga gjithsej 20. Politikanët, jozyrtarisht për Institutin

²⁶ Marija Bashevska - UN Women. 2020. *RAPID GENDER ASSESSMENT: THE IMPACT OF COVID-19 ON WOMEN AND MEN IN NORTH MACEDONIA*. Onlajn: https://www2.unwomen.org/-/media/field_percent20office_percent20eca/attachments/publications/2020/09/rga_the_percent20impact_percent20of_percent20COVID-19_nm_eng_final_2020_09_29-min.pdf?la=en&vs=2420

²⁷ Ibid.

²⁸ UN General Assembly. 2020. *Progress towards gender equality under threat, world leaders warn as General Assembly marks twenty-fifth anniversary of landmark women's rights conference*. Onlajn: <https://reliefweb.int/report/world/progress-towards-gender-equality-under-threat-world-leaders-warn-general-assembly-marks>

Nacional Demokratik pranuan që brenda organeve për menaxhim me kriza ose nuk ka asnjë, ose një numër i vogël i grave marrin pjesë në punën e tyre. Edhe në takimet e udhëheqjes së liderëve të partive të thirrur nga Presidenti Pendarovski, zakonisht nuk ka ose ka vetëm një grua në tryezë, zakonisht ish-Ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska. Fatkeqësisht, kjo pasqyron pozicionin e përgjithshëm të grave në partitë politike. Vetëm një numër i vogël i grave mbajnë poste të larta në udhëheqjet e partive (zëvendëskryetare ose nënkryetare) dhe ka vetëm një kryetare të një partie politike në parlament.²⁹

Qeveria paraprake³⁰ e Maqedonisë së Veriut miratoi tre pako të masave të krizës në mbështetje të qytetarëve dhe ekonomisë. Këto pako u miratuan pa përfshirjen e Parlamentit pasi që i njëjti u shpërnda në atë kohë dhe u shpall gjendje e jashtëzakonshme. Këto pako me ndihma u miratuan më 19 mars, 31 mars dhe 17 maj në një vlerë totale prej 550 milionë euro. Qeveria e re miratoi një pako të katërt të masave me vlerë 470 milionë euro, e cila u miratua në 27 shtator 2020. Pakot përfshinin masa për stimulimin e ekonomisë (fiskale dhe monetare), mbështetjen e bizneseve dhe ruajtjen e vendeve të punës, zgjerimin e mbrojtjes sociale për qytetarët më të rrezikuar, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e punëtorëve, stimulimin e kompensimit për produktet vendore dhe zhvillimin dhe përmirësimin e konkurrencës së kompanive maqedonase.

Në kuadër të dy pakove të para të masave të krizës, vetëm dy nga 27 masat dallohen duke marrë

parasysh specifikën e krizës dhe mënyrën se si ajo mund të ndikojë ndryshe te gratë në krahasim me burrat. Masa e parë, e cila u miratua për mbylljen e kopshteve dhe shkollave, parashikonte të drejtën e lirit të një prindi me leje me pagesë për t'u kujdesur për një fëmijë nën moshën 10 vjeçare gjatë kohëzgjatjes së krizës. Në praktikë, megjithatë, kjo masë është përdorur më shpesh nga gratë e punësuar, duke rezultuar me tërheqjen e tyre nga obligimet profesionale dhe mundësitë që i ofron puna për të përparuar.

Masa tjetër që përqendrohet tek gratë ka qenë zgjatja e përkohshme e pushimit të lehonisë me pagesë që ka përfunduar gjatë muajve të krizës si dhe pushimi me pagesë nga puna për punonjësit me probleme shëndetësore kronike dhe personat me aftësi të kufizuara. Masa e parë u ka mundësuar të gjitha grave që ishin në pushim të lehonisë në kohën kur u miratua të vazhdonin edhe më tej të merrnin rrogë nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor.

Për më tepër, Ministria e Brendshme deklaroi se ora policore nuk do të zbatohet për viktimat e dhunës në familje. Kjo masë është zhvilluar në bashkëpunim me Rrjetin Kombëtar kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje. Lidhur me këto masa, qëllimi i pjesës tjetër të punimit hulamtues është të vlerësojë përshtatshmërinë e masave nga perspektiva e grave dhe vajzave në Maqedoninë e Veriut.

²⁹ *Win with Women Violence Against Women in Political Parties Assessment Report*, National Democratic Institute, Skopje, 2020: Onlajn: <https://www.ndi.org/publications/north-macedonia-violence-against-women-politics-assessment>

³⁰ Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Maqedoninë e Veriut u mbajtën më 15 korrik 2020. Fillimisht ishin të planifikuara për në nëntor 2020, por Kryeministri Zoran Zaev bëri thirrje për zgjedhje të parakohshme pasi që Këshilli Evropian nuk arriti të dakordohet për fillimin e negociatave me Maqedoninë e Veriut për pranim në Bashkimin Evropian në tetor të vitit 2019. Data e zgjedhjeve u caktua për 12 prill, por u shty për në korrik për shkak të pandemisë së COVID-19 në Maqedoninë e Veriut.

Anketimi i grave dhe vajzave në Maqedoninë e Veriut

—

Anketimi u realizua prej 21 deri më 25 nëntor 2020 bazuar në një qasje sasiore duke përdorur një anketë telefonike CATI-Intervistë Telefonike e Asistuar nga Kompjuteri, (CATI-Computer Assisted Telephone Interview)³¹. Anketa kombëtare për mendimin publik e vlerësoi ndikimin e COVID-19 mbi gratë në moshën më të vjetër se 18 vjet dhe përdorimin dhe ndikimin e masave të ndihmës. Hulumtimi u krye në një ekzemplar reprezentativ në nivel kombëtar prej 1,100 të anketuarave nga Republika e Maqedonisë së Veriut më të vjetra se 18 vjet dhe një ekzemplar plotësues për përforcimin prej 370 anketueseve nga kategoritë e mëposhtme: gra që punojnë në ekonominë joformale, gra pronare të mikro ndërmarrjeve, gra fermere, gra rome aktive në tregun e punës, gra të reja me potencial sipërmarrës të moshës 18+; nga 75 të anketuara nga secili prej këtyre grupeve. Ekzemplari reprezentativ ishte i nivelit kombëtar për sa i përket moshës, përkatësisë etnike, rajoneve statistikore dhe vendbanimit (zonat urbane dhe rurale). Secili prej tetë rajoneve statistikore në Maqedoninë e Veriut ishin të shtresuar sipas nivelit të urbanizimit. Numri i intervistave në secilin nga 16

nivelet (rajonale, urbane dhe rurale) ishte proporcional me madhësinë e popullsisë së vlerësuar në nivelin e dhënë. Margjina e vlerësuar e gabimit në përcaktimin e ekzemplarit për anketë ishte $\pm 2,95$ pikë përqindje për 95 për qind interval besimi.

Nga të anketuarit 100 për qind ishin gra. Pesëdhjetë e tetë për qind jetonin në zonat urbane dhe 42 për qind në zona rurale. Duke qenë se ekzemplari ishte i përfaqësuar në nivel rajonal, përqindja më e lartë (28.7%) e të anketuarave jetonin në rajonin e Shkupit. Lidhur me përkatësinë etnike, 67 për qind e të anketuarave ishin maqedonase, 24 për qind shqiptare dhe 9 për qind anëtare të bashkësive të tjera etnike (rome, turke, serbe, boshnjake, etj.). Shpërndarja e ekzemplarit sipas grup-moshave tregon se 30 për qind e grave kanë qenë midis moshës 18 dhe 34 vjeç, ndërsa 39 për qind e grave kanë qenë midis moshës 35 dhe 54, ndërsa 31 për qind e grave kanë qenë të moshës 55+. Informacion shtesë mbi pyetëtorin dhe karakteristikat demografike mund të gjendet në Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2.

REZULTATET NGA ANKETA

—

Në përgjithësi, mund të vlerësohet se rezultatet nga anketa mund të ndahen në 6 nënseksione - *Shqetësim në lidhje me situatën me COVID-19, Pasojat financiare, Përdorimi i ndihmës/masës financiare, Kujdesi për*

fëmijët dhe të moshuarit/personat me aftësi të kufizuara, Mbrojtja shëndetësore, dhe Sfidat.

Rezultatet e sondazhit do të analizohen më tej në përputhje me ato nënseksione.


³¹ Ky hulumtim u realizua nga TIM Institut (Shkup, Maqedonia e Veriut) me mbështetjen e NDI-së. Të anketuarit u zgjedhën rastësisht; Sa i përket gjinisë, është zgjedhur ajo pjesëtarë e familjes e cila e ka datelindjen e para sipas renditjes.

SHQETËSIMET NË LIDHJE ME SITUATËN ME COVID-19

Rezultatet e sondazhit treguan se shumica dërrmuese e të anketuarave (86%) janë të shqetësuar për situatën me Covid-19 në vend. Për më shumë se gjysmën e të anketuarave (53%), situata me COVID-19 është jashtëzakonisht shqetësuese, ndërsa 32% e të anketuarave janë deri diku të shqetësuar. Nëntë për qind e të anketuarave nuk janë as të shqetësuar dhe as të pashqetësuar, ndërsa 4% e të anketuarave nuk janë të shqetësuar.

Të anketuarat janë më të shqetësuar për veten e tyre dhe shëndetin e familjes dhe miqve të tyre (93%) dhe gjendjen financiare të familjes së tyre (47%). Njëzet e dy për qind e të anketuarave kanë qenë të shqetësuar për gjendjen ekonomike të vendit dhe papunësinë, 20 për qind për mirëqenien e tyre emocionale dhe 16 për qind për izolimin shoqëror.

Grafikoni 1. Për çfarë shqetësoheni më SHUMË? (Më shumë përgjigje) (%)




PASOJAT FINANCIARE

Gjetjet e sondazhit tregojnë se gratë janë të shqetësuar për pasojat ekonomike të COVID-19 në Maqedoninë e Veriut. Më shumë se 80 për qind e të

anketuarave janë deri diku të shqetësuar (41%) ose jashtëzakonisht të shqetësuar (41%).


Grafikoni 2. Sa jeni të shqetësuar për pasojat ekonomike të krizës Covid-19 (Corona) në vend? (%)



Shumica (69%) e grave janë të shqetësuara për gjendjen financiare të familjes së tyre si rezultat i ndikimit të krizës me COVID-19 në familjen e tyre. Kur krahasohen përgjigjet e grave nga zonat urbane dhe rurale, përqindja e grave nga zonat rurale të cilat kanë shprehur shqetësime është më e lartë. Gjashtëdhjetë e gjashtë për qind e të anketuarave nga zonat rurale

janë deri diku të shqetësuara, (33%) të shqetësuara, ndërsa jashtëzakonisht të shqetësuara janë (42%). Në zonat urbane, 65 për qind e të anketuarave janë të shqetësuara për gjendjen financiare të familjes së tyre si rezultat i ndikimit të krizës me COVID-19 ndaj familjes së tyre (Grafikoni 3).


Grafikoni 3. Sa jeni të shqetësuar për gjendjen financiare të familjes suaj si rezultat i ndikimit të krizës me COVID-19 (Corona) ndaj familjes suaj? (%)



Sipas moshës, gratë e moshës 34 deri 54 vjeçe janë më të shqetësuarat (75%) për gjendjen financiare të familjes së tyre. Ato ndiqen nga gratë e moshës 55 vjeçe dhe më të vjetra. Gjashtëdhjetë e tetë për

qind e grave mbi moshën 55 vjeçe, krahasuar me 64 për qind të grave midis moshave 18 dhe 34 vjeçe. (Grafikoni 3a).

Grafikoni 3a. Sa jeni të shqetësuara për gjendjen financiare të familjes suaj si rezultat i ndikimit të krizës me Covid-19 ndaj familjes suaj? (%)




Për sa i përket aktivitetit ose pasivitetit në punë, 55 për qind e grave nuk kanë punuar (të papuna, amvise, studente, pensioniste). Nga 44 për qind e atyre që punojnë në mënyrë aktive, 44 për qind e të anketuarave janë të shqetësuara për sigurinë e punës së tyre / punës së ardhshme, si rezultat i krizës COVID-19, krahasuar me 42 për qind të grave të cilat janë deri diku ose nuk janë aspak të shqetësuara. Përqindja më e lartë e grave të shqetësuara janë midis moshës 35 dhe 54 (48%), ndërsa përqindja më e ulët e grave të shqetësuara janë midis moshës 18 dhe 34 (34%).

Lidhur me nivelin e arsimit, përqindja më e lartë e shqetësimit për sigurinë e punës së tyre / punës së ardhshme, si rezultat i krizës me COVID-19, është midis grave dhe vajzave që kanë arsim fillor (68%). Gratë me arsim të lartë ose të mesëm janë më pak të shqetësuara (34%). Midis këtyre dy kategorive janë gratë që kanë mbaruar arsimin e mesëm (48%).

Shqetësimet në lidhje me sigurinë e vendit të punës / punën e tyre të ardhshme, si rezultat i krizës COVID-19, gjithashtu varen nga sektori në të cilin punojnë gratë. Shqetësimi më i madh është tek gratë e vetëpunësuar (77%), të ndjekura nga gratë fermere (72%) dhe gratë që punojnë në sektorin joformal siç janë pastrueset nëpër shtëpi, gratë që kujdesen për fëmijët dhe kujdestaret e personave të moshuari etj. (53%). Nga ana tjetër, gratë e punësuar në sektorin publik janë më pak të shqetësuara për vendin e punës së tyre. Vetëm 32 për qind e të anketuarave në sektorin publik janë të shqetësuara për vendet e tyre të punës, ndërsa 59 për qind nuk janë të shqetësuara. Gratë e punësuar në sektorin privat (48 për qind janë të shqetësuara) vijojnë pas tyre. Një zbulim interesant është se e njëjta përqindje e grave që janë pronare të biznesit janë të shqetësuara për biznesin e tyre (45 për qind) dhe nuk janë të shqetësuara (45 për qind). Tetë për qind e këtyre grave nuk janë as të shqetësuara dhe as të pashqetësuara. (Grafikoni 4).

Grafikoni 4. Sa jeni të shqetësuara për sigurinë e punës / punës suaj të ardhshme, si rezultat i krizës Covid-19 (Corona) (%)



SHFRYTËZIMI I NDIHMËS / MASËS FINANCIARE


Gjetjet nga sondazhi treguan se në 6 muajt e fundit, 20 për qind e të anketuarave kanë shfrytëzuar ndonjë lloj asistence, masë financiare, ndihmë në lidhje me punën ose ndonjë masë sociale. Në anën tjetër, 79 për qind e të anketuarave nuk kanë shfrytëzuar asnjë lloj ndihme. Përqindja më e lartë e grave që kanë shfrytëzuar ndonjë lloj ndihme kanë qenë gratë midis moshës 18-34 (31%), me çka vijon grupmosha midis 35-54 (20%). Numri më i ulët i grave që kanë shfrytëzuar ndonjë lloj ndihme shtetërore kanë qenë të moshës 55 vjeçare ose më të vjetra.

Ndër 20 për qind e grave që kanë pasur qasje në ndihmë financiare të siguruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 65 për qind e konsiderojnë këtë ndihmë si të pamjaftueshme. Vetëm 28 për qind e të anketuarave e konsiderojnë të mjaftueshme ndihmën e ofruar. Nga ana tjetër, në mesin e këtyre 20 për qind të grave që kanë shfrytëzuar ndihmë, 78 për qind e grave mendojnë se

kjo ndihmë është lehtësisht e disponueshme. Lloji më i zakonshëm i ndihmës së shfrytëzuar ka qenë kartela pagesore për produktet shtëpiake (66%), e ndjekur nga një kupon për pushime (37%), ndihma në vlerë prej 14,500 denarë për punonjës (8%) dhe pastaj një kupon për të rinjtë (7.8%). E njëjta përqindje e grave – 5% – kanë përdorur sigurimin për të papunët dhe ndihmën e garantuar minimale. Katër për qind e të anketuarave kanë thënë se kanë shfrytëzuar beneficione për prindërit që mund të qëndronin në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët nën 10 vjeç. Tre për qind e të anketuarave kanë shfrytëzuar kuona akomodimi për nxënësit e ciklit të parë dhe 2 për qind e grave dhe vajzave përdorën kuona për të blerë pajisje shkollore. Vetëm 0.4 për qind e vajzave dhe grave kanë aplikuar dhe më pas kanë përdorur kuona për të fituar shkathtësi digjitale. Çuditërisht, askush nga të anketuarat nuk kanë shfrytëzuar asnjë shtesë për pagesën e energjisë elektrike.

Grafikonët 5 dhe 6.

Sipas jush a ishte ndihma e mjaftueshme? / A ishte kjo ndihmë lehtësisht e disponueshme? (%)




KUJDESI PËR FËMIJËT DHE MË TË MOSHUARIT / PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Rezultatet e studimit treguan se 39 për qind e të anketuarave kanë fëmijë nën moshën 18 vjeçare në familjet e tyre (17% - një fëmijë; 18% - dy fëmijë, 3% - tre fëmijë). Midis 40 për qind të atyre që kishin fëmijë nën moshën 18 vjeç në familjen e tyre, shumica e grave personalisht kalojnë më shumë kohë për t'u kujdesur për fëmijët sesa para krizës me COVID-19. Tridhjetë e gjashtë për qind e të anketuarave kalojnë shumë më shumë kohë dhe

20 për qind pak më shumë kohë për t'u kujdesur për fëmijët sesa para krizës me COVID-19, ndërsa 44 për qind e të anketuarave kalojnë të njëjtën sasi kohe për t'u kujdesur për fëmijët si më parë. Gratë është dashur të kalojnë më shumë kohë duke u kujdesur për fëmijët e moshës 9-14 vjeç (klasa e katërt deri në të nëntën). Nga ana tjetër, ato kanë kaluar më pak kohë për t'u kujdesur për fëmijët e moshës 15-18 vjeç (shkollë e mesme). (Grafikoni 7).

Grafikoni 7. A shpenzoni personalisht më shumë kohë për t'u kujdesur për fëmijët sesa para krizës me Covid-19?




Lidhur me kujdesin për të moshuarit ose personat me aftësi të kufizuara, shumica e të anketuarave (86%) nuk jetojnë në një familje me një person të moshuar / person me aftësi të kufizuara. Nga 23 për qind e grave që jetojnë me një person të moshuar ose një person me aftësi të kufizuara, 45 për qind shpenzojnë më shumë kohë duke u kujdesur për ta, sesa më parë (24.7 për qind - shumë më shumë kohë dhe 21.2 për qind - pak më shumë kohë).

Kur përqendrohemi në rezultatet e sondazhit në lidhje me punën shtëpiake të papaguar siç janë planifikimi dhe përgatitja e ushqimit, gatimi, pastrimi, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuara, ndihma rreth obligimeve shkollore, është e lehtë të shihet se këto përgjegjësi kryesisht menaxhohen nga gratë. Kur bëhet fjalë për organizimin dhe përgatitjen e ushqimit, deri në 72 për qind e grave

kalojnë më shumë kohë në këto aktivitete gjatë pandemisë sesa partneri i tyre mashkull. Vetëm 6 për qind e të anketuarave janë përgjigjur se partnerët e tyre meshkuj kanë kaluar më shumë kohë në këto aktivitete, ndërsa 22 për qind kanë thënë se dikush tjetër e ka kryer këtë detyrim, por nuk kanë specifikuar gjininë e tyre. Kjo gjithashtu mund të konfirmohet edhe nga përgjigjet e të anketuarave të ndara sipas grupmoshave. Megjithëse në grupmoshat 35-54 dhe

55+ më shumë se 80 për qind e grave kanë qenë të ngarkuara me furnizimin dhe përgatitjen e ushqimit, në grupmoshën 18-34 kjo ka qenë rast tek më pak se gjysma e të anketuarave. Nga ana tjetër, në të gjitha grupmoshat, partnerët meshkuj kanë kaluar më shumë kohë në këto aktivitete në vetëm 5 deri në 7 për qind të rasteve. Në rastin e grupmoshës 18-34 vjeç, deri në 47% dikush tjetër është marrë me këto përgjegjësi, si për shembull ndonjë i afërm. (Grafikoni 8 dhe 8a)

Grafikonët 8 dhe 8a. Në 6 muajt e fundit në familjen tuaj kush shpenzon MË SHUMË KOHË me sa vijon:



Rezultatet e sondazhit janë shumë të ngjashme edhe në aktivitete të tjera të tilla si pastrimi, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuara, dhe ndihmë rreth obligimeve shkollore të fëmijëve. Dallimi i vetëm është në grupmoshën 55+ për sa i përket kujdesit ndaj fëmijëve, obligimeve shkollore dhe kujdesit për të moshuarit ose për personat me aftësi të kufizuara.


Përgjigja më e zakonshme në këtë grupmoshë ka qenë se këto aktivitete janë kryer nga dikush tjetër. Kjo është e kuptueshme duke pasur parasysh që këto aktivitete, nga ana tjetër, kryhen kryesisht nga gra të kategorive që përfaqësojnë gratë më të reja. Sidoqoftë, ky studim gjithashtu konfirmoi se punët e papaguara të shtëpisë vazhdojnë të mbesin një barrë e konsiderueshme për gratë dhe vajzat.

MBROJTJA E SHËNDETËSORE

Për sa i përket mbrojtjes shëndetësore, 72 për qind e të anketuarave nuk kanë pasur nevojë të shfrytëzojnë mbrojtje shëndetësore për problemet shëndetësore që nuk kishin të bënin me COVID-19 në 6 muajt e fundit (nga marsi deri më tani), ndërsa 27 për qind

e grave kanë shfrytëzuar. Për sa i përket kujdesit shëndetësor për ndonjë anëtar të familjes në 6 muajt e fundit, rezultatet janë shumë të ngjashme, pothuajse të njëjta. (Grafikonët 9 dhe 9a)

Grafikonët 9 и 9а. Në 6 muajt e fundit (nga marsi deri më tani) a keni pasur nevojë të shfrytëzoni mbrojtje shëndetësore për problemet shëndetësore që nuk lidhen me COVID-19? / Në 6 muajt e fundit (nga marsi deri më tani) a ka pasur nevojë ndonjë anëtar i familjes (fëmijë / person i moshuar / person me aftësi të kufizuara) për të shfrytëzuar mbrojtje shëndetësore për problemet shëndetësore që nuk lidhen me COVID-19?



Midis 42 për qind të personave që personalisht kanë pasur nevojë për kujdes shëndetësor ose kishin një anëtar të familjes i cili ka pasur nevojë për kujdes shëndetësor për problemet shëndetësore që nuk janë të lidhura me COVID-19, 41 për qind e të anketuarave i kanë marrë të gjitha shërbimet e nevojshme të kujdesit në institucionin shëndetësor publik ose nga

mjeku amë, ndërsa 46 për qind e grave i kanë marrë vetëm pjesërisht. Pesë për qind e të anketuarave nuk i kanë marrë të gjitha shërbimet e nevojshme shëndetësore në një institucion shëndetësor publik ose te mjeku amë, ndërsa 5 për qind e grave kanë marrë kujdes shëndetësor në institucion privat.

SFIDAT

Pandemia e COVID-19 paraqet një sfidë për të gjitha vendet dhe rajonet në botë në fusha të ndryshme, nga sektori i shëndetësisë përmes ekonomisë dhe sigurisë e deri te zhvillimi i qëndrueshëm. Duke u nisur nga rezultatet e këtij sondazhi, për gratë në Maqedoninë e Veriut sfida më e madhe me të cilën u përballën gjatë krizës me COVID-19 është frika e infektimit me virus, shqetësimi dhe pasiguria (19 për qind e të anketuarve). Në vendin e dytë janë distancimi social, izolimi dhe karantina (18 për qind), me çka vijnë kriza ekonomike dhe financiare (11 për qind). Këto sfida shoqërohen me ulje të të ardhurave, ulje të punësimit dhe rritje të kostove (5 për qind), më pas humbja e punës dhe papunësia (4 për qind); kaosi në shëndetin publik dhe mungesa e termineve për kontrollë të rregullta (4 për qind); pastaj pandemia

dhe vetë virusi (3 për qind); cilësia e arsimit dhe mësimdhënia në internet on-lajn (2.6 për qind); kujdesi për shëndetin e fëmijëve dhe anëtarëve të moshuar të familjes (2 për qind) dhe disa përgjigje të ngjashme. Dhjetë për qind e të anketuarve nuk kanë ndonjë problem të madh, dhe 9 për qind nuk e dinë.

Në të gjitha grupmoshat e anketuara, tre sfidat më të mëdha janë të njëjtat (frika nga infeksioni me virus, shqetësimi dhe pasiguria, distancimi social, izolimi dhe karantina; kriza ekonomike dhe financiare), vetëm renditja ndryshon. Grupmosha 18-34 vjeçe e konsideron izolimin shoqëror si sfidën më të madhe, ndërsa dy grupmoshat e tjera konsiderojnë si sfida më të mëdha frikën nga infeksioni, shqetësimin dhe pasigurinë. (Grafikoni 10).

Grafikoni 10. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballeni gjatë krizës me COVID-19?

Sfida më e madhe me të cilën përballeni që nga fillimi i krizës KOVID – 19 e deri më sot?	18 - 34	35 - 54	55+
Kriza ekonomike, financiare	8,5	14,8	8,8
Isha KOVID – 19 pozitiv	1,8	0,7	2,1
Frika nga infeksioni KOVID-19, ankthi, pasiguria	13,7	20,3	25,1
Distancimi shoqëror, izolimi, karantina	22,9	13,9	19,8
Kriza e përgjithshme nga virusi, kaosi në shoqëri	1,2	2,3	2,9
Cilësia e arsimit, mësimi on line	5,5	2,3	0,3
Higjiena, dezinfektimi i shpeshtë i duarve dhe rrobave, mbajtja e maskave	1,5	1,4	0,9
Kaosi në shëndetin publik, mungesa e termineve për kontrolle të rregullta	2,4	2,5	7,4
Kujdesi për shëndetin e fëmijëve dhe të moshuarve në familje	2,1	1,8	3,2
Turma të mëdha në tregje dhe barnatore	0,9	0,5	0,6
Humbja e vendit të punës, papunësia	5,2	4,4	2,4
Ulja e të ardhurave, zvogëlimi i ngarkesës së punës, rritja e kostove	5,8	7,4	3,8
Mosrespektimi i masave të mbrojtjes nga qytetarët	1,8	0,2	0,3
Unë nuk kam pasur një problem të rëndësishëm	11,6	10,4	9,4
Pandemija, vetë virusi KOVID-19	3,0	3,7	3,2
Rritja e përgjegjësive në shtëpi dhe në vendi të punës	0,6	0,9	0,6
Ndryshimi i mënyrës së jetës, realiteti i ri	0,6		0,3
Tjetër	0,6	1,8	1,5
Nuk e din	10,1	10,6	7,4
Total	100	100	100

Nga aspekti i përkatësisë etnike, gratë maqedonase kanë pothuajse njëloj frikë nga distancimi shoqëror, izolimi dhe karantina aq sa nga infektimi me virusin.

Ndërsa gratë shqiptare kanë më shumë frikë të infektohen nga virusi dhe më pas nga kriza ekonomike dhe financiare. (Grafikoni 10a).

Grafikoni 10a. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballeni gjatë krizës me COVID-19??



Sfida më e madhe me të cilën përballeni që nga fillimi i krizës KOVID – 19 e deri më sot?	Macedonian	Albanian	Other
Kriza ekonomike, financiare	9,8	13,9	13,5
Isha KOVID – 19 pozitiv	1,6	1,5	
Frika nga infeksioni KOVID-19, ankthi, pasiguria	21,0	18,1	15,4
Distancimi shoqëror, izolimi, karantina	21,3	9,7	19,2
Kriza e përgjithshme nga virusi, kaosi në shoqëri	2,8	0,8	1,0
Cilësia e arsimit, mësimi on line	2,7	9,7	19,2
Higjiena, dezinfektimi i shpeshtë i duarve dhe rrobave, mbajtja e maskave	1,6		1,9
Kaosi në shëndetin publik, mungesa e termineve për kontrolle të rregullta	4,6	1,5	5,8
Kujdesi për shëndetin e fëmijëve dhe të moshuarve në familje	1,6	3,9	3,8
Turma të mëdha në tregje dhe barnatore	0,7		1,9
Humbja e vendit të punës, papunësia	3,0	6,9	3,8
Ulja e të ardhurave, zvogëlimi i ngarkesës së punës, rritja e kostove	6,1	3,1	10,6
Mosrespektimi i masave të mbrojtjes nga qytetarët	0,9	0,4	
Unë nuk kam pasur një problem të rëndësishëm	12,6	3,9	11,5
Pandemija, vetë virusi KOVID-19	2,2	6,9	2,9
Rritja e përgjegjësive në shtëpi dhe në vendi të punës	0,9		1,0
Ndryshimi i mënyrës së jetës, realiteti i ri	0,4		
Tjetër	1,2	1,5	1,9
Nuk e din	4,7	26,3	1,0
Total	100	100	100

Implikimet gjinore nga karantina si rritja e dhunës me bazë gjinore gjithashtu duhet të identifikohen si një sfidë. Tridhjetë e tetë për qind e të anketuarave vlerësojnë se shteti ka marrë masat e duhura për të mbrojtur gratë që kanë vuajtur nga dhuna fizike ose psikologjike, ndërsa 22 për qind e të anketuarave vlerësojnë të kundërtën. Zbulim i rëndësishëm është fakti se shumica e të anketuarave (39 për qind) nuk e dinë ose nuk kanë informacione për rritjen e rrezikut të dhunës me bazë gjinore që nga fillimi i pandemisë. Kjo mund të nënkuptojë se qasja në informacione mbi këtë çështje dhe informacionet mbi shërbimet e ofruara për personat që kanë përjetuar dhunë në familje është i pamjaftueshëm (Grafikoni 11).

Ky zbulim konfirmohet gjithashtu nga përgjigjet e të anketuarave në pyetje të tjera: *A e dini cili institucion apo cilat organizata të shoqërisë civile ofrojnë ndihmë ose mbrojtje për ata që kanë nevojë për shkak të dhunës fizike ose psikologjike (dhuna në familje)?* Shumica dërrmuese e të anketuarave (78 për qind) nuk e dinë. Vetëm 7 për qind e të anketuarave i përmendën institucionet dhe shërbimet sociale, më pak se 5 për qind e të anketuarave përmendën qendrat për punë sociale (4.4 për qind), Ministrinë e Punëve të Brendshme (3 për qind), Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (2 për qind), OJQ-të (2 për qind) dhe telefonat SOS për dhunën në familje (vetëm 0.3 për qind) (Grafikoni 12).

Grafikonët 10 dhe 11.

Sipas mendimit tuaj, shteti a i merr masat e duhura për të mbrojtur gratë që kanë përjetuar dhunë fizike ose psikologjike (dhunë në familje)? / A e dini cili institucion apo cilat organizata të shoqërisë civile ofrojnë ndihmë ose mbrojtje për ata që kanë nevojë për shkak të dhunës fizike ose psikologjike (dhuna në familje)?



Sipas mendimit tuaj, shteti a i merr masat e duhura për të mbrojtur gratë që kanë përjetuar dhunë fizike ose psikologjike (dhunë në familje)? / A e dini cili

institucion apo cilat organizata të shoqërisë civile ofrojnë ndihmë ose mbrojtje për ata që kanë nevojë për shkak të dhunës fizike ose psikologjike (dhuna në familje)?

Praktikat më të mira nga vendet e tjera - masa specifike për të mbështetur gratë dhe vajzat³²

Për të identifikuar praktikat më të mira që synojnë të ndihmojnë në ndikimin socio-ekonomik të COVID-19 mbi gratë dhe vajzat, ky punim do të citojë shembuj nga pesë vende evropiane - Estonia, Gjermania, Sllovakia, Suedia dhe Zvicra. Për këtë qëllim, autori zhvilloi një pyetësor për të mbledhur informacion mbi masat e marra nga vendet individuale, qeveritë dhe parlamentet e tyre për të parandaluar ndikimin negativ socio-ekonomik të pandemisë COVID-19 mbi gratë dhe vajzat. Punonjësit e Qendrave Parlamentare të Kërkimit dhe Zyra Federale Zvicerane për Barazi Gjinore iu përgjigjën këtij pyetësori, përpos nëse specifikohet ndryshe.

Në përgjithësi, mund të vlerësohet se masat

individuale mund të ndahen në 6 grupe - *Masat e kompensimit të të ardhurave, Shtesat prindërore dhe përfitimet për kujdes gjatë pandemisë / harmonizim të jetës private dhe profesionale gjatë krizës, Ndihma financiare SOS për ata që nuk mundin të kërkojnë ndihmë tjetër / qasje në papunësi të pjesshme, Programin e ndihmës për sëmundje / Ditë të lira për personat e sëmurë, masat për të mbuluar dhe mbrojtur punëtorët në sektorin joformal dhe masat për të parandaluar dhunën në bazë gjinore.* Një pikë tjetër e rëndësishme për t'u theksuar është se megjithëse shumica dërrmuese e masave të marra dhe të paraqitura më poshtë janë neutrale në aspektin gjinor, në praktikë ato shpesh në masë të konsiderueshme lehtësojnë barrën mbi gratë.

MASAT PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE

Estonia ka miratuar një *Program të kompensimit të përkohshëm për reduktimin e të ardhurave për fuqinë e punës.* Programi ka siguruar të ardhura për punonjësit dhe ka ndihmuar punëdhënësit të tejkalojnë vështirësitë e përkohshme pa pasur nevojë të pushonin nga puna punonjësit ose të falimentonin. E njëjta u pagua për dy muaj, nga marsi në maj, për punonjësit, punëdhënësit e të cilëve u prekën nga rrethanat e jashtëzakonshme të shkaktuara nga COVID-19. Shtesa maksimale ishte 1.000 euro në muaj për punonjës. Shtesa e paguar, si rregull i përgjithshëm, ishte 70 për qind e pagës bruto të punonjësit në 12 muajt e mëparshëm.

Në Sllovaki, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit, duke përfshirë gratë pronare të mikro-ndërmarrjeve,

për shembull në parukeri dhe sallone bukurie, butikë veshjesh, kanë mundur të kërkojnë kompensim financiar në bazë të projektit të ndihmës së parë deri në mars të vitit 2021. Në të njëjtën kohë, subvencionet e siguruara janë rritur nga tetori 2020. Punëdhënësit që kanë mbyllur dyqanet e tyre ose të cilëve u është dashur të mbyllin dyqanet e tyre gjithashtu kanë mundur të kërkojnë ndihmë edhe për punonjësit e punësuar pas 1 marsit 2020, por jo më vonë se 2 shtator 2020. Në të njëjtën kohë, në grupin e kërkuesve të kompensimit tani përfshihen personat juridikë dhe të vetëpunësuarit që kanë themeluar bizneset e tyre pas 1 shkurtit 2020, por jo më vonë se 2 shtator të vitit 2020. Kompensimi është rritur nga 80 për qind nga të ardhurat mesatare për punonjës në 80 për qind të kostove totale për

³² Shkruar në bazë të të dhënave të siguruara nga Qendrat Parlamentare të Kërkimit dhe Zyra Federale Zvicerane për Barazi Gjinore, përpos nëse nuk specifikohet ndryshe.

punonjës për periudhën kur punëdhënësi është ballafaquar me probleme. Në të njëjtën kohë, periudha për të cilën atyre u është kërkuar të mbajnë punonjësin u shkurtua nga dy muaj në një muaj gjatë gjendjes së jashtëzakonshme kombëtare. Grupi i të vetëpunësuarve është zgjeruar me ata të cilët kanë obligim të paguajnë sigurim shëndetësor dhe pensional pas 1 korrikut 2020. Në të njëjtën kohë, kërkesa që këtyre personave u ndalohej të kishin një leje për tregti dhe kontratë pune është shfuqizuar.

Qeveria zvicerane gjithashtu ka marrë masa të një natyre ekonomike. Në Zvicër, për shembull, është miratuar kompensimi për humbjet financiare, duke mbështetur individët të cilët preken drejtpërdrejt ose indirekt nga mbylljet zyrtare dhe ndalimet e ngjarjeve. Ky kompensim gjithashtu është dedikuar për artistë solo, performimet e të cilëve janë anuluar. Ata që janë të prekur mund të marrin kompensim për të ardhurat e humbura.

SHTESAT PRINDËRORE DHE PËRFITIMET PËR KUJDES GJATË PANDEMISË / HARMONIZIMI I JETËS PRIVATE DHE PROFESIONALE NË KOHË KRIZE

Në Estoni, të gjitha shkollat, nga fillorja në universitet, janë mbyllur me urdhër të qeverisë që nga 16 mars, dhe klasat e rregullta janë zëvendësuar me e-mësim, ndërsa me punën dhe organizimin e punës me kopshtet dhe qendrat ditore vendosin autoritetet lokale dhe operatorët e tjerë të kopshteve. Varësisht nga autoritetet lokale, prindërit u liruan tërësisht ose u liruan pjesërisht nga pagesa e shtesës për kujdesin ndaj fëmijëve. Shteti nuk i obligoi institucionet e kujdesit për fëmijët që të mbyllen, por u bëri thirrje prindërve që të mos i çonin fëmijët e tyre në kopsht. Autoritetet lokale kanë qenë të obliguara të garantojnë se ata do të siguronin kujdes për fëmijët nëse prindërit duhet të shkonin në punë, d.m.th. për prindërit që punojnë për shembull në shëndetësi, polici, shërbime shpëtimi, shërbime sociale, transport, prodhim ushqimi, supermarketet, etj. Gjithashtu, një numër i autoriteteve lokale vazhduan të sigurojnë vakte shkollore për fëmijët (disa si vakte me ushqime të ngrohta dhe të tjerët si pako me ushqim), por për grupin e synuar specifik (për shembull fëmijë nga familje me gjendje të vështirë, etj.) edhe kushte të tjera për sa u përket vakteve të ushqimit shkollorë janë përcaktuara nga autoritetet lokale.

Në Estoni, një ndihmë e përkohshme speciale u miratua gjithashtu për prindërit e fëmijëve me nevoja

të veçanta të cilët kishin nevojë për mbikëqyrje dhe mbështetje shtesë si në mësim, ashtu edhe në higjienën personale në shtëpi. Kjo ndihmë ka qenë e siguruar si një zëvendësim për të ardhurat e prindit i cili, për shkak të nevojës për t'u kujdesur për një fëmijë me nevoja të veçanta, ishte i detyruar përkohësisht të mungonte në punë. Shtesa iu është ndarë prindit që kujdeset për fëmijë me aftësi të kufizuara të rënda, fëmijë me imunitet të dobësuar ose fëmijë me disa nevoja të veçanta arsimore, ndërsa prindi duhej të paraqesë pushim pa pagesë. Shuma e ndihmës ishte 70 për qind e pagës mesatare të prindit, me ç'rast shuma minimale mujore e ndihmës ka qenë 540 euro dhe maksimumi 1.050 euro. Masa ka qenë e vlefshme deri në fund të gjendjes së jashtëzakonshme.

Një shembull i praktikës së mirë në Sllovaki mund të llogaritet prezantimi i mundësisë së ndërrimit të ndërsjellë të prindërve të cilët merrnin përfitime të kujdesit. Në rast se bëhet fjalë për fëmijë nën 11 vjeç ose në rast të fëmijës nën 18 vjeç, kur fëmija është në gjendje të sëmurë afatgjatë nuk ka nevojë të kontaktohet pediatri (nuk ka nevojë që pediatri të konfirmojë çdo gjë), e drejta e përfitimit të kujdesit fillon automatikisht pasi shkolla / institucioni parashkollor i fëmijës do të mbyllet. Agjencia Sllovaqe e Sigurimeve Social (SIA) ndan ndihmë për

kujdesin e fëmijës për të gjithë prindërit (përfshirë prindërit zëvendësues) për fëmijët deri në moshën 11 vjeç, pavarësisht nëse ata shkojnë ose jo në shkollë / institucion parashkollor pa vërtetim mjekësor / peditër, respektivisht edhe për ata prindër që kanë pranuar ndihmë prindërore nga Zyra e Punës ose atyre që u ka përfunduar pushimi prindëror para se fëmija të mbushte tre vjet dhe gjithashtu ata prindër, fëmija i të cilëve nuk ka qenë i vendosur në kopsht, por për të është kujdesur një kujdestar / gjyshi, gjyshja etj. Prindërit që marrin këtë përfitim mund të ndërrohen (edhe pas disa ditësh). Për një propozim të tillë është diskutuar disa herë në Parlamentin Sllovak në përbërjen e tij të fundit parlamentare (2016-2020), por asnjëherë nuk është aprovuar. Sot, prindërit në Sllovaki që marrin një përfitim të tillë mund të ndërrohen. Kjo është një risi, më parë vetëm një prind, zakonisht gruaja, mund të merrte një përfitim të tillë. Ky ndryshim siguron që jo vetëm një prind, zakonisht gruaja, të mungojë në punë. Meqenëse shkollat janë të mbyllura për një kohë të gjatë, prindërit që qëndrojnë në shtëpi me fëmijën ndërrohen.

Shtesa prindërore pandemike në Sllovaki u jepet prindërve që nuk kanë të drejtë për ndihmë prindërore sepse fëmija i tyre ka arritur moshën tre vjeçe (ose gjashtë vjet nëse ka probleme shëndetësore afatgjata) gjatë krizës. Shtesa përfshin edhe fëmijët për të cilët kujdeset shteti ose nëse kanë kaluar tre vjet që kur vendimi i parë për kujdesin ndaj fëmijëve është marrë nga një person i autorizuar. Këta persona duhet të marrin shtesën në të njëjtën shumë me shtesën e rregullt prindërore që e kanë marrë deri në fund të krizës.

Qeveria zvicerane ka futur masa për të kufizuar humbjen e të ardhurave të lidhura me krizën. Prindërit e fëmijëve nën moshën 12 vjeç mund të marrin një ndihmë nëse duhet të ndalojnë së kryeri punën që fitojnë sepse nuk ka institucione të qasshme të kujdesit për fëmijë. Kjo vlen edhe për familjet me një prind. Merren parasysh edhe raste kur kategoritë e cenuara të personave si (p.sh. gjyshërit) nuk mund të kujdesen më për fëmijët. Shtesa mbulon 80 për qind të të ardhurave të mëparshme. Kohëzgjatja e disponueshmërisë së kësaj shtese të tillë ndryshon në varësi të situatës. Që nga 30 gushti i vitit 2020, janë paguar më shumë se 14.000 ndihma shtesë.

Për të siguruar harmonizimin e jetës private dhe profesionale gjatë krizës, kujdesi për fëmijët në qendrat e kujdesit ditor, familjet e kujdesit ditor dhe shkollat është garantuar në kantonin zviceran të Bernit. Më 22 prill 2020, Këshilli i Shtetit (qeveria e Kantonit) vendos që të ndihmojë prindërit që kujdesen për fëmijët e tyre në shtëpi veçanërisht për shkak të COVID-19 duke mbuluar kostot e institucioneve të kujdesit për fëmijët që nuk i kanë përdorur për shkak të pandemisë.

Gjermania ka siguruar shtesa të reja page për kujdestarët për të mbuluar pjesërisht ose plotësisht pagën e prindërve ose atyre që kujdesen për personat e sëmurë në familje gjatë kohës së pandemisë. Gjermania gjithashtu siguroi fonde shtesë për prindërit kur shërbimet e kujdesit për fëmijët dhe shkollat janë të mbyllura.³³

³³ UNDP-UN Women. 2020. COVID-19 Global Gender Response Tracker: Global Fact Sheet. Onlajn: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/COVID-19-Global-Gender-Response-Tracker.html>

NDIHMJA FINANCIARE SOS PËR ATA QË NUK MUND TË KËRKOJNË NDIHMË TJETËR / QASJE DERI TE PAPANËSIA E PJESSHME

Në Sllovaki, gjatë valës së parë të pandemisë COVID-19, qeveria miratoi dhe gjatë valës së dytë rifilloi ndihmën financiare SOS, duke u thirrur në gjendjen e jashtëzakonshme në vend si arsye. Kjo është një shumë deri në 300 euro dhe u ofrohet rreth 10.000 kërkuesve çdo muaj. Ata që kanë humbur të ardhurat e tyre për shkak të krizës dhe nuk mund të kërkojnë ndonjë ndihmë tjetër, të tilla si projekti për mbrojtjen e vendeve të punës ose ndihmë nga sistemet e sigurimeve sociale, mbështetja sociale nga shteti dhe ndihma sociale, mund të dorëzojnë kërkesë për këtë ndihmë financiare. Megjithatë kjo masë duket të jetë neutrale në aspektin gjinor, në praktikë shpesh e lehtëson në veçanti barrën mbi gratë. Qeveria zvicerane gjithashtu ka lehtësuar qasjen deri te papunësia e pjesshme. Puna me orar të shkurtuar gjithashtu është vazhduar dhe procedurat e kualifikimit për këtë janë thjeshtuar, përkatësisht

përmes masave në vijim. Deri në fund të gushtit 2020, kompensimi i punës me kohë të shkurtuar ka mundur të paguhet gjithashtu për punonjësit me kohë të caktuar, punonjësit që kanë punuar në thirrje dhe personat që punojnë për organizatat të përkohshme të punës. Deri në fund të majit, personat që ishin në një pozicion të ngjashëm si punëdhënës dhe për bashkëshortët ose partnerët e regjistruar të personave të tillë, punonjës në kompani, si dhe praktikantë gjithashtu kanë pasur të drejtë për kompensim për punën me kohë të shkurtuar. (Grupi i parë kishte të drejtën e një pagese me shumë të njëjtë). Në përgjithësi shtesa e punësimit me kohë të shkurtuar zakonisht mbulon 80 për qind të të ardhurave të mëparshme. Në kulmin e përdorimit të kompensimit të punës me kohë të shkurtuar në prill të vitit 2020, 2.7 miliardë franga zvicerane u paguan 1.3 milionë punonjësve.

PROGRAMI I SHITESËS PËR SËMUNDJE / DITË TË LIRA PËR PERSONAT E SËMURË

Programi i shtesës për sëmundje ka qenë përkohësisht i zgjeruar për të mbuluar edhe tre ditët e para të pushimit mjekësor ku në Estoni më parë kanë qenë në llogari të vetë personit.

së tyre ose njerëz të tjerë për të cilët kujdesi është i detyrueshëm. Megjithatë këto masa duket të jenë neutrale në aspektin gjinor, në praktikë ato shpesh lehtësojnë barrën ndaj grave.

Kantoni i Schaffhausen-it në Zvicër, si punëdhënës, kryesisht mbështet mundësitë për të punuar nga shtëpia. Numri i mungesave për shkak të kujdesit për fëmijë është rritur. Ditët e mungesave në punë u krijuan për njerëzit që janë të sëmurë dhe për ata që duhet të kujdesen për anëtarët e sëmurë të familjes

Siç u tha më parë, Gjermania ka siguruar shtesa të reja në pagë për kujdestarët për të mbuluar pjesërisht ose plotësisht pagën e prindërve ose atyre që kujdesen për anëtarët e sëmurë në familje gjatë pandemisë.³⁴

³⁴ UNDP-UN Women. 2020. COVID-19 Global Gender Response Tracker: Global Fact Sheet. Onlajn: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/COVID-19-Global-Gender-Response-Tracker.html>

MASAT PËR TË PËRFSHIRË DHE MBROJTUR GRATË PUNËTORE NË SEKTORIN JOFORMAL

-

Pandemia e COVID-19 ka ndikuar masivisht në migrimin qarkullues të kujdestarëve që jetojnë atje ku punojnë midis vendeve në të cilat jetojnë dhe punojnë. Sidomos kujdestarët e personave të moshuar nga Sllovakia që punojnë në Austri. Për këto arsye, Austria ka kërkuar rregulla më të thjeshta për kujdestarët sllovakë në Austri. Përveç kësaj, Austria konsiderohej një vend me rrezik në atë kohë. Si rezultat i kësaj, ata që kanë hyrë në Sllovaki nga Austria është dashur të tregonin ose një test negativ PCR jo më të vjetër se 72 orë ose të regjistroheshin në [korona.gov.sk](https://www.korona.gov.sk)

(numri i telefonit, vendi i izolimit dhe emri i mjekut amë) dhe të shkonin në izolim shtëpiak. Gjatë hyrjes në vend duhet t'u tregoni nëpunësve të policisë një konfirmim të regjistrimit tuaj në faqen e internetit. Sidoqoftë, ka disa përjashtime të caktuara, të cilat përfshijnë kujdestarët e të moshuarve, por edhe për ata persona që duhet të kujdesen për anëtarët e familjes së tyre; punëtorë të shëndetësisë; fermerë, toka e të cilëve është brenda 10 km largësi nga kufijtë; punonjës social; punëtorë ndërkufitarë dhe disa sportistë dhe artistë.³⁵

MASAT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE

-

Në Estoni, policia, qendrat për mbrojtje të viktimave, qendrat për mbështetje të grave, autoritetet lokale dhe institucione të tjera vazhdojnë të ndihmojnë viktimat - numri i shërbimeve nuk është ulur gjatë pandemisë. Viktimat gjithashtu këshillohen në një linjë telefonike për viktimat e cila punon non-stop dhe personat mund të kërkojnë ndihmë dhe këshilla në estonisht, rusisht dhe anglisht. Për më tepër, Bordi Estonez për Sigurim Social përqendrohet gjithashtu në fushatat e informimit. Në vitin 2019 realizoi një fushatë, mesazhi i së cilës ishte "Kërkimi i ndihmës është vepra më e madhe heroike" e cila sugjeronte se gjëja më e rëndësishme është të ndër marrësh hapin e parë dhe të kërkojë ndihmë. Këtë vit, gjatë pandemisë, hipoteza e fushatës ka qenë se viktimat e dhunës në familje nuk mund të jetë në gjendje të kërkojë ndihmë, duke pasur parasysh që të dy autorët dhe viktimat janë vazhdimisht në shtëpi dhe qëllimi i fushatës së informimit ishte që t'u bënte thirrje vëzhguesve nga anëtarë të regjistrojnë dhe t'i ndihmojnë viktimat e dhunës në familje (kolegët dhe fqinjët të cilët janë të

vetëdijshëm për dhunën mund të ndihmojnë t'i jepet fund të njëjtës).

Dhuna ndaj grave dhe familjeve është raportuar gjerësisht nga publiku gjatë valës së parë të korona virusit në Sllovaki. Numri i përgjithshëm i thirrjeve në Linjën Kombëtare të Telefonave për Gratë Viktima të Dhunës (NLWEV) të Institutit për Hulumtime të Punës dhe Familjes është dyfishuar midis marsit dhe qershorit 2020, kur Sllovakia shpalli gjendjen e parë të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë. Këshilltarët që punojnë për Linjën Kombëtare të Telefonit, si dhe analistët në Qendrën për Koordinimin dhe Metodologjinë për Parandalimin e Dhunës, vlerësojnë se rritja e mbulimit mediatic të dhunës ndaj grave në Sllovaki mund të jetë një nga arsyet për raportimin e dhunës në familje. Gjithashtu një nga përparësitë e presidentes së parë grua të Sllovakisë, Zuzana Čaputová, u përqendrua në ndihmën gjatë pandemisë për gratë, fëmijët dhe grupet e tjera personash të ekspozuar ndaj dhunës në familje. Izolimi social që

³⁵ Vlen për nëntorin e vitit 2020, por situata mund të ketë ndryshuar gjatë dhjetorit 2020 ose janarit 2021

parandalon përhapjen e virusit, për ta do të thotë një cenueshmëri më e madhe dhe rrezik më i madh për t'u ekspozuar ndaj dhunës psikologjike, fizike, seksuale dhe të tjera. Në të njëjtën kohë ka më pak mundësi për të kërkuar ndihmë. Kriza ka treguar se sa e rëndësishme është që viktimat e dhunës në familje të jenë në gjendje të telefonojnë dhe të kërkojnë ndihmë shpejt, në mënyrë të sigurt dhe diskrete. Policia sllovaqe ka zhvilluar një vegël në formën e një aplikacioni celular. Aplikacioni aktualisht është i disponueshëm si një version pilot në Rajonin e Trençin-it dhe duhet të shtrihet gradualisht në të gjithë territorin e Republikës Sllovaqe. Aplikacioni duhet të ndihmojë për të kërkuar ndihmë shpejt, në mënyrë të sigurt dhe diskrete.

Gjatë krizës, Qendra për Intervenim kundër Dhunës në Familje në kantonin zviceran të Bernit filloi fushatën #stressathome, e cila synonte të rrisë ndërgjegjësimin për problemin e dhunës në familje tek ata që preken drejtpërdrejt dhe dëshmitarët. Në maj, pesë mesazhe iu dërguan banorëve të kantonit të Bernit përmes Facebook dhe Instagram duke e rritur ndërgjegjësimin për këtë çështje.

Në fillim të krizës, ekspertët kishin frikë se problemi i dhunës në familje do të intensifikohej për shkak të lirisë së kufizuar të lëvizjes në Zvicër. Prandaj, konfederata dhe kantonet kanë formuar një grup pune për të luftuar dhunën në familje në mënyrë që të jenë në gjendje të rivlerësojnë rregullisht situatën në fushën e dhunës në familje, përfshirë këtu edhe çështjen e mbrojtjes së fëmijëve. Aktivitetet përfshijnë edhe një fushatë me postera në trembëdhjetë gjuhë me qëllim që të gjithë personat e prekur të dinë se ku të kërkojnë ndihmë. Përveç kësaj, disa kantone kanë rregulluar shërbimet e tyre mbështetëse dhe kanë rritur akomodimin e tyre në strehimore për të përballuar rritjen e mundshme të numrit të rasteve të dhunës. Gjatë gjithë periudhës

së COVID-19, qasja në shërbimet këshilluese dhe akomodimi në raste urgjente janë të garantuara vazhdimisht. Konfederata gjithashtu ka siguruar mbështetje financiare shtesë për linja të ndryshme telefonike. Konferenca e Drejtorëve Kantonalë për Çështjet Sociale gjithashtu ka realizuar një fushatë në mediat sociale duke informuar në lidhje me përfitimet e mbështetjes së viktimave në Zvicër. Kjo fushatë u drejtohet veçanërisht të rinjve që janë viktima të dhunës në familje. Grupi i Punës vazhdon të takohet rregullisht për të siguruar koordinimin e vazhdueshëm, shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin midis Konfederatës dhe kantoneve. Deri më tani, policia nuk ka evidentuar një rritje të konsiderueshme të rasteve të dhunës në familje në Zvicër. Sidoqoftë, në disa nga qendrat e këshillimit për viktimat ekziston një tendencë drejt rritjes së numrit të raportimit të rasteve të reja të dhunës në familje. Situata ndryshon nga rajoni në rajon / kanton në kanton.

"Ueb faqja e iniciativës së Qeverisë Gjermane #strongerthanviolence i bashkon shërbimet ekzistuese të mbështetjes për gratë viktima të dhunës dhe ofron zgjidhje praktike. Si pjesë e kësaj iniciative, qeveria ka nisur një fushatë mbarëkombëtare në supermarkete "A nuk jeni të sigurt në shtëpi?" Me qëllim që të informohen personat që përballen me dhunë në familje si dhe miqtë dhe familjet e tyre në lidhje me ndihmën dhe shërbimet mbështetëse në dispozicion.³⁶

Në Suedi, fonde shtesë - afërsisht 9 milionë € (10.5 milion dollarë) - u sigurohen organizatave të shoqërisë civile në mbështetje të punës së tyre në luftën kundër dhunës ndaj grave, fëmijëve dhe partnerëve intimë LGBTIQ+ ose anëtarëve të familjes.³⁷

³⁶ UNDP-UN Women. 2020. *COVID-19 Global Gender Response Tracker: Factsheet: Europe, Northern America, Australia and New Zealand*. Onlajn: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/COVID-19-Global-Gender-Response-Tracker.html>

³⁷ UNDP-UN Women. 2020. *COVID-19 Global Gender Response Tracker: Global Fact Sheet*. Onlajn: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/COVID-19-Global-Gender-Response-Tracker.html>

ROLI I PARLAMENTEVE

Roli kryesor i parlamenteve në kriza të tilla është t'u përgjigjen sa më shpejt të jetë e mundur masave të marra nga qeveria, të bashkëpunojnë me qeverinë dhe së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, të dalin me iniciativat e tyre, planet e veprimit dhe ligjet si përgjigje e situatës së dobët socio-ekonomike të qytetarëve të tyre dhe natyrisht që gjatë kësaj të marrin parasysh perspektivën gjinore në këtë proces.

Për shembull, miratimi i ligjeve me procedurë të shkurtuar mund të konsiderohet si një përgjigje e shpejtë. Në Sllovaki, në gjendje të jashtëzakonshme ku të drejtat dhe liritë themelore të njeriut ose siguria kombëtare janë në rrezik ose kur ekziston një kërcënim se vendi mund të pësojë dëme të konsiderueshme ekonomike, Këshilli Kombëtar, me kërkesë të Qeverisë, mund të vendosë të rishikojë një ligj me procedurë të shkurtuar. Masat e sipërpërmendura në Sllovaki miratohen pothuajse ekskluzivisht me procedura të shkurtuara legjislative.

Në Estoni, gjatë valës së parë të pandemisë të COVID-19 kur është shpallur gjendje e jashtëzakonshme në vend, parlamenti ka miratuar katër ligje në dy javë e gjysmë mbi masat në lidhje me përhapjen e korona virusit që shkakton sëmundjen COVID-19.

Në Zvicër, gjatë kohës së pandemisë janë botuar disa studime që kanë të bëjnë me pandeminë nga këndvështrimi i barazisë. Këto studime mund të shërbejnë si një bazë e mirë për qeverinë dhe parlamentin për të vendosur se çfarë masash duhet të ndërmarrin për të shmangur pasojat negative gjinore që dalin nga pandemia. Për shembull, Grupi Punues Shkencor Kombëtar Zviceran për COVID-19, i cili këshillon autoritetet në kontekstin e krizës, ka botuar një Përmbledhje të shkurtër të politikave për çështje lidhur me barazinë.³⁸ Studim i porositur

nga Zyra Federale për Barazi Gjinore (FOGE) dhe botuar në qershor të vitit 2020 siguroi indikacione të evolucionit të fuqisë punëtore në Zvicër gjatë pandemisë. Studimi tregon se detyrat shtesë në lidhje me shkollimin nga shtëpia dhe zvogëlimin e mundësive të kujdesit për fëmijët ndikuan në aftësinë e punës së të anketuarave. Ky ndikim është zbuluar të jetë më i madh tek gratë që punojnë sesa tek burrat.³⁹ Instituti Federal i Teknologjisë së Lozanës (*Ecole polytechnique fédérale de Lausanne*) në bashkëpunim me Institutin e Kërkimit Idiap (*Idiap Research Institute*) dhe Institutin e Psikologjisë të Universitetit të Lozanës (*Institute of Psychology of the University of Lausanne*) ka botuar një studim mbi përvojat e burrave dhe grave zvicerane në periudhën e vetë-izolimi për shkak të COVID-19, veçanërisht për sa i përket barazisë. Ky studim tregon se gjatë pandemisë barra mbi gratë ka qenë jo proporcionale. Në Zvicër, "karantina e pjesshme ka rezultuar me - ose rritje - në shumë forma të pabarazisë gjinore. Megjithëse vetëm 3 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se e kanë humbur punën e tyre, 70 për qind e atyre që humbën punën kanë qenë gra. Shumica e grave gjithashtu kanë ndjerë se kushtet e tyre të punës u janë bërë më të vështira; shumë prej tyre kanë thënë se kanë qenë të punësuar në sektorin shëndetësor dhe social dhe prandaj për to ka ekzistuar një rrezik më i lartë nga infeksioni. Gjithashtu, një në dy gra kanë raportuar se kanë qenë të vetmet përgjegjëse për shkollimin nga shtëpia krahasuar me burrat, ku ky proporcion është një në 10 burra. Është interesant të përmendet se dukshëm më shumë burra sesa gra deklaruan se kjo ka qenë një detyrim që ata ndanin së bashku. Më në fund, më shpesh gratë e reja të punësuar dhe të diplomuara kanë raportuar se kanë marrë më shumë përgjegjësi në shtëpi."⁴⁰ Qeveria dhe parlamenti zviceran mund t'i përdorë këto gjetje për të miratuar politika për të mbështetur vajzat dhe gratë.

³⁸ See more: ELSI Report. 2020. *Gender aspects of COVID-19 and pandemic response*. Onlajn: <https://sciencetaskforce.ch/wp-content/uploads/2020/10/Gender-aspects-of-COVID19-and-pandemic-response-14-May-20-EN.pdf>

³⁹ See more: FOGE. 2020. *Schweizer Familien in der COVID-19-Pandemie*. Onlajn: <https://www.news.admin.ch/news/message/attachments/61708.pdf>

⁴⁰ EPFL, the Idiap Research Institute and the University of Lausanne's Institute of Psychology. 2020. *How the Swiss fared under partial lockdown*. Onlajn: <https://actu.epfl.ch/news/how-the-swiss-fared-under-partial-lockdown/>

Rekomandime për ndryshimin e politikave ekzistuese dhe prezantimin e politikave të reja në Maqedoninë e Veriut

Rezultatet e studimit treguan se, sipas shumicës së grave, ndihma shtetërore dhe masat e marra për të ulur efektet negative socio-ekonomike të pandemisë kanë qenë të pamjaftueshme. Gjetjet gjithashtu sugjerojnë që në 6 muajt e fundit vetëm 25 për qind e të anketuarave kanë përdorur ndonjë lloj ndihme, masë financiare, ndihmë në lidhje me punën ose ndihmë sociale. Tetëdhjetë për qind e të anketuarave nuk kanë përdorur asnjë lloj ndihme. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që këto gra dhe vajza nuk kishin nevojë për ndihmë shtetërore. Kjo mund

të nënkuptojë gjithashtu se ato nuk i kanë plotësuar kushtet për ndonjë ndihmë dhe për atë qëllim nuk kanë mund të paraqiten. Prandaj, kur merren masa socio-ekonomike, është e rëndësishme që pjesa më e madhe e mundshme e popullsisë së prekur të mund të aplikojë për to dhe që ky “rrjet i sigurisë shtetërore” të jetë i mjaftueshëm me qëllim që njerëzit që kanë nevojë të mos mbeten anësh. Prandaj, në këtë pjesë do të propozohen rekomandime për ndryshimin e politikave ekzistuese dhe prezantimin e politikave të reja në Maqedoninë e Veriut.

REKOMANDIMET PËR MIRATIMIN E MASAVE PËR KOMPENSIM TË TË ARDHURAVE

Në përgjithësi është e mundur të propozohet miratimi i ndihmës financiare, e cila do të garantojë të ardhurat e punonjësve dhe do të ndihmojë punëdhënësit të tejkalojnë vështirësitë e përkohshme pa nevojën e pushimit nga puna të punonjësve ose të falimentojnë, veçanërisht për sektorët më të prekur nga pandemia, ku gratë zakonisht janë më të përfaqësuara ose dominojnë. Kjo ndihmë financiare do të paguhet nga shteti për punonjësit,

punëdhënësit e të cilëve preken nga rrethanat e jashtëzakonshme të shkaktuara nga COVID-19. Një rekomandim tjetër është miratimi i kompensimit financiar për personat e vetëpunësuar, i cili gjithashtu përfshin gratë pronare të mikro ndërmarrjeve të tilla si parukierë dhe sallone bukurie, butikë veshjesh. Këto profesione nuk mund të funksiononin gjatë pandemisë për shkak të rrezikut të lartë të infeksionit me COVID-19 gjatë punës së tyre.

REKOMANDIME PËR TË LEHTËSUAR BARRËN E GRAVE QË KUJDESEN PËR FËMIJËT, FAMILJEN, TË MOSHUARIT DHE SHTËPINË

Rezultatet e studimit konfirmuan se punët e papaguara të shtëpisë vazhdojnë të imponojnë një barrë të konsiderueshme për gratë. Për sa i përket punës së shtëpisë, siç janë planifikimi dhe përgatitja e ushqimit, gatimi, pastrimi, kujdesi për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara,

ndihma rreth obligimeve shkollore, është e lehtë të shihet se këto përgjegjësi menaxhohen kryesisht nga gratë. Bazuar në këtë, është e përshtatshme të rekomandohet një ndryshim në masën e miratuar për mbylljen e kopshteve dhe shkollave në Maqedoninë e Veriut, me të cilën është siguruar e drejta e lirit të

njërit prej prindërve për t'u kujdesur për një fëmijë / fëmijë nën 10 vjeç gjatë krizës. dhe në praktikë është përdorur më shpesh nga gratë. Vlen të merret në konsideratë prezantimi i mundësisë që prindërit të mund të ndërrohen në kujdesin për fëmijët apo edhe të moshuarit. Prindërit që kujdesen për fëmijët ose të moshuarit duhet të kenë të drejtë të ndërrohen (qoftë edhe për disa ditë) dhe të marrin një shtesë për kujdesin. Një ndryshim i tillë mund të lejojë që jo vetëm një prind, zakonisht gruaja, të mungojë në punë.

Opsioni i dytë është që të mos obligohen institucionet për kujdesin e fëmijëve të mbyllën,

por të thirren prindërit të mos i çojnë fëmijët e tyre në institucione të kujdesit për fëmijë si në Estoni. Autoritetet lokale duhet të jenë të detyruara të garantojnë se ato do të sigurojnë kujdes për fëmijët nëse prindërit duhet të shkojnë në punë, d.m.th. për prindërit që punojnë për shembull në shëndetësi, polici, shërbime shpëtimi, shërbime sociale, transport, prodhim të ushqimit, supermarkete, etj. Autoritetet lokale gjithashtu mund të sigurojnë vakte shkollore për fëmijët (disa si një vaktushqim i ngrohtë, disa si një pako ushqimore) duke pasur parasysh ato grupe që janë të goditura më shumë nga pandemia.

SOS NDIHMA FINANCIARE UNIVERSALE PËR ATA QË NUK MUND TË KËRKOJNË NDIHMË TJETËR / QASJE NË NDIHMË TË PJESSHME TË PAPANËSISË

-

Gjatë kohës së pandemisë e deri më tani, ekziston mundësia që disa gra të mos mund të aplikojnë për ndonjë ndihmë socio-ekonomike për shkak të qasjes në kriteret e përcaktuara. Prandaj, do të ishte e përshtatshme të merret parasysh aplikimi i ndihmës financiare universale SOS për të cilën do të paraqiteshin gratë që kanë humbur burimin e tyre të ardhurave ose nuk mund të gjejnë punë për shkak të krizës dhe nuk mund të kërkojnë ndonjë ndihmë tjetër, siç është projekti për ruajtjen e vendeve të punës ose ndihmën nga sistemet e sigurimeve sociale, mbështetja sociale nga shteti dhe ndihma sociale.

Një mundësi tjetër është të lehtësohet qasja në papunësinë e pjesshme. Puna me kohë të shkurtuar

mund të zgjatet dhe procedurat e kualifikimit për një ndihmë të tillë të mund të thjeshtohen përmes masave të ngjashme me ato të miratuara nga Qeveria zvicerane. Për shembull, kompensimi për punë me kohë të shkurtuar gjithashtu mund të paguhet për punonjësit me kontratë për punë me kohë të përcaktuar, punonjësit që punojnë në thirrje dhe personat që punojnë për organizata për punë të përkohshme. Personat që janë në një pozitë të ngjashme si punëdhënës dhe bashkëshortët ose partnerët e regjistruar të personave të tillë, punonjës në kompani, si dhe praktikantë gjithashtu mund të kenë të drejtën e kompensimit për punën me kohë të shkurtuar. Në përgjithësi kompensimi për papunësi do të mbulojë 80 për qind të të ardhurave të mëparshme.

PROGRAMI PËR KOMPENSIM GJATË SËMUNDJES / DITË TË LIRA PËR PERSONA QË JANË TË SËMURË

Disa artikuj profesionalë pohojnë se gratë mund të jenë më të ekspozuara ndaj COVID-19. "Kjo mund të jetë për shkak se më shumë gra janë të punësuara në ballë të shërbimeve të kujdesit, me çka janë të ekspozuara ndaj më shumë kontakteve (të tilla si arkëtarët, pastrueset dhe infermieret). Globalisht, rreth 70 për qind e punonjësve të kujdesit shëndetësor janë gra dhe kjo mund të jetë një nga arsyt kryesore për shkallën e lartë të grave të infektuara (si dhe shkallën më të lartë të testimit të grave)."⁴¹ Shteti duhet të shohë nëse kjo është situata në Maqedoninë e Veriut dhe të merret parasysh kur do të aprovet kompensimi për sëmundje.

Skema e kompensimit për sëmundje mund të

zgjerohet përkohësisht për të mbuluar të paktën 10 ditë pushim mjekësor, që është kohëzgjatja minimale e karantinës. Gjatë karantinës, punonjësi do të ketë të drejtën e një kompensimi adekuat dhe mundësi aplikimi për një kompensim të tillë pa shkuar tek ndonjë autoritet kompetent, që do të thotë të jetë on-lajn.

Opsioni i dytë është garantimi i mundësive për punë nga shtëpia ose ditët në mungesë për njerëzit e sëmurë dhe ata që duhet të kujdesen për anëtarët e sëmurë të familjes së tyre ose njerëz të tjerë për të cilët kujdesi është i detyrueshëm. Megjithëse këto masa janë neutrale për sa i përket gjinisë, në praktikë ato shpesh lehtësojnë barrën e grave.

REKOMANDIM PËR TË PËRFSHIRË DHE MBROJTUR GRATË EMIGRANTE QË PUNOJNË NË SEKTORIN JOFORMAL

Siç është potencuar më parë, pandemia me COVID-19 ka ndikuar rëndë në migrimin qarkullues të kujdestarëve që jetojnë atje ku ata punojnë midis vendeve të tyre nga vijën si dhe shtëpive të pleqve në vendet tjera, veçanërisht kujdestareve të personave të moshuar.

Kjo është arsyeja pse shtetet nuk duhet të mbyllen plotësisht, por duhet të negociojnë dhe të përpiqen të thjeshtojnë rregullat për kujdestaret, në mënyrë që gratë të mos humbin punën e tyre dhe në anën tjetër të moshuarit të mos mbeten pa kujdes dhe ndihmë.

REKOMANDIME PËR PARANDALIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE

Në të gjitha vendet e botës - policia, shërbimet për mbështetjen e viktimave, qendrat e mbështetjes së grave, autoritetet lokale dhe institucionet e tjera duhet të vazhdojnë të ndihmojnë viktimat. Sidomos në kohë të pandemisë është e nevojshme të mos neglizhohet tema e dhunës në familje dhe të diskutohet shumë për atë - numri i shërbimeve nuk mund të reduktohet. Linjat e ndihmës non-stop janë shumë të rëndësishme dhe duhet të jenë të

disponueshme në të gjitha gjuhët që përdoren në Maqedoninë e Veriut.

Gjithashtu është e rëndësishme që përqendrimi të jetë në fushatat informuese. Rezultatet e sondazhit treguan se shumica e të anketuarave nuk e dinë ose nuk kanë informacion në lidhje me këtë fenomen negativ. Kjo mund të nënkuptojë që debati dhe njohuritë për një temë kaq të rëndësishme siç është

⁴¹ Clint Witchalls. 2020. *How COVID-19 puts women at more risk than men*. Onlajn: <https://theconversation.com/how-COVID-19-puts-women-at-more-risk-than-men-in-gauteng-south-africa-150570>

dhuna në familje janë akoma të pamjaftueshme në Maqedoninë e Veriut. Ky zbulim konfirmohet gjithashtu nga përgjigjet e të anketuarve në pyetje të tjera: A e dini cili institucion apo cilat organizata të shoqërisë civile ofrojnë ndihmë ose mbrojtje për ata që kanë nevojë për shkak të dhunës fizike ose psikologjike (dhunës në familje)? Shumica dërmuese e të anketuarave (78 për qind) nuk e dinë. Vetëm 7 për qind e të anketuarave përmendën institucionet sociale dhe shërbimet, më pak se 5 për qind e të anketuarave përmendën qendrën për punë sociale (4.4 për qind), Ministrinë e Punëve të Brendshme (3 për qind), Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (2 për qind), OJQ-të (2 për qind) dhe telefonat SOS për dhunë në familje (vetëm 0.3 për qind). Prandaj, faktorët e rëndësishëm në Maqedoninë e Veriut mund të frymëzohen nga një fushatë e kryer në Estoni që synon t'u bëjë thirrje të huajve për të vëzhguar dhe ndihmuar viktimat e dhunës në familje, siç janë kolegët dhe fqinjët që janë të vetëdijshëm për dhunën. Në lidhje, për të ndihmuar në përfundimin e dhunës (gjatë pandemisë hipoteza e fushatës ishte se viktimat e dhunës në familje nuk mund të kërkonte ndihmë pasi kryerësi dhe viktimat ishin vazhdimisht në shtëpi së bashku). Një shembull tjetër që mund të përdoret në Maqedoninë e Veriut është fushata e posterëve në të gjitha gjuhët që përdoren për të gjithë ata që janë të interesuar të dinë se ku të gjejnë ndihmë. Përveç kësaj, shërbimet për mbështetjen e viktimave mund të rrisin kapacitetin e tyre akomodues në strehimore për të përballuar rritjen e mundshme të numrit të rasteve të dhunës. Gjatë gjithë periudhës së COVID-19 në Zvicër, qasja në këshillim dhe strehim urgjent është vazhdimisht e garantuar. Konfederata gjithashtu ka siguruar mbështetje shtesë financiare për linja të ndryshme telefonike. Për më tepër, Konferenca e Drejtorëve Kantonalë për Qështjet Sociale ka zhvilluar një fushatë në mediat sociale duke informuar në lidhje

me përfitimet e mbështetjes së viktimave, e cila mund të shërbejë si një shembull i praktikës së mirë për Maqedoninë e Veriut.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, policia në bashkëpunim me qeverinë dhe institucionet e tjera mund të përpiqen të krijojnë një vegël në formën e një aplikacioni celular. Izolimi shoqëror me të cilin vendet parandalojnë përhapjen e virusit tek gratë, fëmijët dhe grupet e tjera të njerëzve që përballen me dhunë në familje do të thotë një cenueshmëri dhe një rrezik më i madh i ekspozimit ndaj dhunës psikologjike, fizike, seksuale ose të tjera. Në të njëjtën kohë ka më pak mundësi për të kërkuar ndihmë. Në Sllovaki, një aplikacion i tillë u lansua si një aplikacion pilot në vitin 2020. Aplikacioni duhet të ndihmojë për të thirrur për ndihmë shpejt, në mënyrë të sigurt dhe diskrete.

Siç u përmend më lart, qeveritë dhe parlamentet në të gjithë botën kanë ndërmarrë hapa për të adresuar pasojat negative socio-ekonomike të pandemisë COVID-19. Disa janë më shumë ndërsa disa të tjerë më pak të suksesshëm në këtë. Kur miratohen masa, është e rëndësishme që pjesa më e madhe e mundshme e popullatës së prekur të mund të regjistrohet për këto dhe që ky "rrjet i sigurisë shtetërore" të jetë i mjaftueshëm për njerëzit që kanë nevojë të mos mbeten anësh. Sidoqoftë, është gjithashtu e rëndësishme të vlerësohen masat e marra dhe nëse është e nevojshme për t'i ndryshuar ato, por gjithashtu të frymëzohen nga shembujt e praktikave të mira nga vendet e tjera. Duhet të kihet parasysh gjithashtu se gjatë situatave të krizës është e nevojshme më shumë se kurrë të kujtojmë se "Nevojiten masa për të forcuar integritimin e njohurive, përvojës dhe ekspertizës së grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara në organizatat politike dhe shoqërore, si dhe në media dhe sfera të tjera publike."⁴²

⁴² ELSI Report. 2020. *Gender aspects of COVID-19 and pandemic response*. Onlajn: <https://scienctaskforce.ch/wp-content/uploads/2020/10/Gender-aspects-of-COVID19-and-pandemic-response-14-May-20-EN.pdf>

Përfundim

Puna jonë kërkimore dhe studime të tjera ndërkombëtare mbi këtë dhe epidemitë e mëparshme tregojnë se këto lloj krizash ndikojnë ndryshe tek gratë në krahasim me burrat. Njëra nga arsyet është se ato shpesh duhet të merren me barrën e rënies së punësimit nga njëra anë dhe nevojën në rritje për t'u kujdesur për fëmijët nga ana tjetër. Përkundër faktit se kriza aktuale ka një ndikim të madh në shumë sektorë dhe profesione, krahasuar me recesionet "e rregullta", të cilat kanë një ndikim më serioz në punësimin e burrave sesa gratë, rënia e punësimit e lidhur me masat e distancës sociale ndikon shumë në sektorët me një përfaqësim të lartë të grave të punësuar. Përveç kësaj, mbyllja e shkollave dhe qendrave të kujdesit ditor ka rritur masivisht nevojën për kujdes të fëmijëve, gjë që ka një ndikim veçanërisht të madh tek nënat që punojnë.⁴³ Literatura, të dhënat dhe gjetjet e paraqitura në këtë punim konfirmojnë se gratë dhe vajzat kanë pësuar dëme të mëdha shoqërore dhe ekonomike nga pandemia e COVID-19.

Prandaj, qëllimi i këtij punimi është të identifikojë masat strategjike dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë që merren në mënyrë efektive me pasojat ekonomike të COVID-19 mbi gratë dhe vajzat në Evropë. Prandaj, punimi kërkimor do të tregojë praktikën më të mira nga disa vende evropiane në lidhje me masat socio-ekonomike që synojnë eliminimin e efekteve negative të COVID-19 mbi gratë, përfshirë rolin e parlamenteve në monitorimin e politikave publike. Bazuar në shembuj të praktikës së mirë nga vendet e analizuar - Estonia, Gjermania, Sllovakia, Suedia dhe Zvicra - dhe rezultatet e një sondazhi telefonik mbi efektet e COVID-19 në kategori të ndryshme të grave në Maqedoninë e Veriut, ky punim rekomandon

se si të përshtaten programet ekzistuese kombëtare të mbrojtjes sociale për të siguruar të ardhura për sektorët e prekur nga COVID-19, ku gratë janë më të përfaqësuara, dhe për të forcuar rolin mbikëqyrës të Parlamentit në zbatimin e masave qeveritare për të luftuar Covid-19 dhe aplikimin e propozuar të politikave të reja në Maqedoninë e Veriut. Hipotezat që supozuan se gratë përballen me rrezik më të madh sesa burrat për të pësuar nga çrregullimet në tregti si rezultat i pandemisë me COVID-19 dhe që një pjesë më e madhe e grave humbin punën e tyre për shkak të punës dhe kujdesit të papaguar shtëpiak gjatë pandemisë në Maqedoninë e Veriut. Ne konfirmuam hipotezat duke u bazuar në statistikat e disponueshme dhe rezultatet e sondazhit telefonik. Gratë kanë norma shumë më të ulëta të punësimit sesa burrat, ndërsa më shumë se gjysma personave joaktive në tregun e punës janë gra. Gjithashtu, gratë që janë zyrtarisht të punësuar fitojnë më pak se burrat për shkak të përfaqësimit të tyre të ulët në pozitat menaxhuese, diskriminimit të tyre në tregun e punës dhe përfaqësimit më të lartë në industritë me vlerësim më të ulët të punës dhe pagave më të ulëta. Burrat përfaqësojnë shumicën midis punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve. Gratë përfaqësojnë shumicën e të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Ato janë gjithashtu shumicë në industrinë e tekstilit ku shumica marrin paga më të ulëta se mesatarja.⁴⁴ Për më tepër, këta sektorë u goditën rëndë nga kriza me COVID-19.

Analiza jonë gjithashtu konfirmon se ekziston ende një tendencë e ngarkesës jo proporcionale mbi gratë kur bëhet fjalë për punë dhe kujdes të papaguar të shtëpisë. Rezultatet e sondazhit në lidhje me

⁴³ Alon et al. 2020. *THE IMPACT OF COVID-19 ON GENDER EQUALITY*. Na internet: https://www.nber.org/system/files/working_papers/w26947/w26947.pdf

⁴⁴ Marija Bashevska - UN Women. 2020. *RAPID GENDER ASSESSMENT: THE IMPACT OF COVID-19 ON WOMEN AND MEN IN NORTH MACEDONIA*. Onlajn: https://www2.unwomen.org/-/media/field_percent_20office_percent_20eca/attachments/publications/2020/09/rga_the_percent_20impact_percent_20of_percent_20COVID-19_nm_eng_final_2020_09_29-min.pdf?la=en&vs=2420

detyrat e papaguara të shtëpisë siç janë planifikimi dhe përgatitja e ushqimit, gatimi, pastrimi, kujdesi për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, ndihmë rreth obligimeve shkollore konfirmojnë se këto përgjegjësi mbarten pothuajse ekskluzivisht nga gratë.

Një gjetje tjetër interesante e këtij dokumenti është se shumë gra dhe vajza nuk dinë ose nuk kanë informacion në lidhje me dhunën me bazë gjinore. Kjo mund të nënkuptojë që debati dhe njohuritë mbi një temë kaq të rëndësishme siç është dhuna në familje nuk janë ende mjaft të pranishme në Maqedoninë e Veriut. Ky zbulim nxjerr në pah rëndësinë e fushatave informuese që synojnë ndërgjegjësimin për këtë fenomen negativ.

